



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 22 regjistër (JR)
Datë 26.06.2020

Nr. 18 i vendimit
Datë 08.06.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 08.06.2022, në orën 15:00, ditën e mërkurë, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 22/2020, datë 26.06.2020, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në parashtrime dhe konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga Komisionerja Publike Irena Nino, që kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi dhe dëgjoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi dhe të avokatit të tij Viktor Gumi, të cilët kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Banushi, me detyrë gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Dritan Banushi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) bazuar në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin² për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), në cilësinë e organit ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse siç janë pasqyruar më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale – duke marrë vendimin nr. 229, datë 28.01.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 229, datë 28.01.2020, vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi, me detyrë gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

¹ Përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 08.01.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 07.05.2019, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KZHD-së nr. {***}, datë 14.05.2019, përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2019.

³ Raporti i KLD-së nr. {***} prot., datë 13.04.2018.

6.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Nga hetimi i thellë administrativ për vlerësimin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme dhe, pas verifikimit, rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

6.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

6.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional. Nga shqyrtimi në tërësi i denoncimeve, duket se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe figurën e subjektit të rivlerësimit.

7. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Dritan Banushi ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme.
 - a. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
 - b. Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
 - c. Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

8. Komisioneri Publik, më datë 12.03.2020, ka ushtruar ankim⁴ ndaj vendimit të Komisionit nr. 229, datë 28.01.2020, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Dritan Banushi. Komisioneri Publik në ankim ka parashtruar se, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, çmon se vendimi nr. 229, datë 28.01.2020, i Komisionit është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim "Kolegji"). Ankimi i Komisionerit Publik, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka evidentuar dhe parashtruar si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore të evidentuara nga Komisioni, për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe për të cilat Komisioneri Publik çmon se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën. Komisioneri Publik kërkon që Kolegji, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:
 - o Ndryshimin e vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi.
9. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

⁴ Brenda afatit ligjor 15-ditor, të parashikuar nga neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

9.1 Subjekti i rivlerësimit është në pamundësi për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasuritë e vëna, shpenzimet e deklaruara dhe kursimet e krijuara në formën e likuiditeteve në depozita bankare dhe në *cash*, të deklaruara gjatë viteve në deklaratimet periodike vjetore.

9.2 Subjekti i rivlerësimit, për pasurinë apartament me sipërfaqe 85,5 m², në Gjirokastrë, të deklaruar në përdorim, ndodhet në kushtet:

a) e pasaktësisë dhe pamjaftueshmërisë në deklarimin e pasurisë në përdorim, si në deklaratimet periodike vjetore, ashtu dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit;

b) e mosjustifikimit të vërtetësisë së deklaratimeve mbi gjendjen faktike të apartamentit të blerë nga babai i tij në momentin e blerjes, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

IV. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

- 10.** Subjekti i rivlerësimit, më datë 16.03.2020, i është drejtuar Kolegjit me kundërankim⁵ ndaj ankimit të Komisionerit Publik. Apeli kundërshtues i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhet me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për ato çështje të vlerësimit të këtij kriteri, të cilat janë ankimuar nga Komisioneri Publik.

Në kundërankim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtimet ndaj shkaqeve të ankimit, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, janë si më poshtë.

A. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, në lidhje me analizën financiare për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar se:

10.1 Komisioneri Publik duhet të sqaronte se cilin element të analizës financiare të kryer nga Komisioni, trajton ndryshe, për secilin vit të analizuar. Komisioneri Publik diku gabon në analizën financiare që kryen, por duke mos paraqitur asnjë tabelë, asnjë sqarim për përlllogaritjet e kryera prej tij, asnjë referencë krahasuese me tabelat e analizës së Komisionit, ia bën të pamundur subjektit të rivlerësimit, paraqitjen e argumenteve për kundërshtimin e konkluzioneve të tij. Për këto arsye, Kolegji duhet të vlerësojë se ankimi i Komisionerit Publik në këtë drejtim, jo vetëm që bazohet në të dhëna *a priori*, që nuk gjejnë mbështetje në provat e marra gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, apo në ndonjë provë tjetër, por për më tepër cenon parimin e barazisë së armëve, duke i hequr subjektit të rivlerësimit mundësinë për të kundërshtuar për fakte apo prova që mund jenë mbajtur parasysht në kryerjen e këtij vlerësimi të gabuar nga ana e Komisionerit Publik.

10.2 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për shumën 290.000 lekë, e cila përfaqëson shpenzimin për një udhëtim të vajzës së subjektit të rivlerësimit në Londër, në vitin 2013, Komisioneri Publik nuk ka mbajtur në konsideratë shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në Komision, sipas të cilave prindërit e tij kanë pasur mundësi që me burime të ligjshme të paguanin shumën e mësipërme.

10.3 Në analizën financiare për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit kundërshton mospërfshirjen në zërin e të ardhurave të shumave prej 3.500 eurosh dhe 100.000 lekësh, të cilat përfaqësojnë dhurata nga të afërmit për vajzën e tij. Komisioneri Publik nuk paraqet ndonjë argument përse këto shuma nuk duhen marrë në konsideratë dhe, për pasojë, këto shuma duhet të konsiderohen si burime të ligjshme të ardhurash, bazuar dhe në provat e shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në Komision.

⁵ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 12.05.2020 dhe datë dorëzimi në shërbimin postar 17.03.2020, sipas zarfës bashkëlidhur kundërankimit.

B. Në lidhje me shkakun e ankimit për pasurinë në posedim, apartament me sipërfaqe 85,5 m², në Gjirokastër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar:

10.4 Në kundërshtim me provat bindëse të paraqitura prej tij, të cilat vërtetojnë plotësisht gjendjen faktike si karabina dhe jo të përfunduar të punimeve të këtij apartamenti, Komisioneri Publik, pa paraqitur qoftë edhe një argument të vetëm kundërshtues të tyre, arrin në konkluzionin e gabuar se ky apartament ka qenë i përfunduar në vitin 2003, në momentin e blerjes nga babai i subjektit të rivlerësimit.

10.5 Në kundërshtim me provat bindëse të paraqitura prej tij, që vërtetojnë plotësisht vlerën reale të blerjes së këtij apartamenti nga babai i tij, Komisioneri Publik, pa paraqitur qoftë edhe një argument të vetëm kundërshtues të tyre, arrin në konkluzionin e gabuar se vlera e kontratës së shitjes për blerjen e këtij apartamenti nuk është reale.

10.6 Në kundërshtim me provat bindëse të paraqitura prej tij që vërtetojnë plotësisht mjaftueshmërinë e të ardhurave financiare të prindërve të tij për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2003, Komisioneri Publik, pa paraqitur qoftë edhe një argument të vetëm kundërshtues të tyre, arrin në konkluzionin e gabuar për pamundësinë financiare të prindërve të tij për të mbuluar me të ardhura të ligjshme vlerën e blerjes së këtij apartamenti, sipas kontratës së shitblerjes së vitit 2003.

11. Në përfundim, në kundërankim, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit mosmarrjen në konsideratë të pretendimeve të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, si të pambështetura në prova e në ligj dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit⁶, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.02.2020, ka njoftuar Institucionin e Komisionerëve Publikë për vendimin nr. 229, datë 28.01.2020, e cila është regjistruar në Institucionin e Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 27.02.2020.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 229, datë 28.01.2020, për subjektin e rivlerësimit Dritan Banushi, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
15. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provave të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij, trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm⁷ vendosi të pranojë të merren në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, analiza e të cilave është pjesë e arsyetimit të trupit gjykues, në vijim, në këtë vendim.
16. Trupi gjykues, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve lidhur me ankimin, me vendim të ndërmjetëm në seancën gjyqësore të datës 26.04.2022, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 213 të Kodit të Procedurës Civile, në funksion të shqyrtimit të çështjes, vendosi paraqitjen nga Komisioneri Publik të analizës financiare për periudhën 2003-2016, në të cilën të reflektoheshin pretendimet e tij të parashtruara në ankim. Analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik, për periudhën 2003-2016, iu paraqit subjektit të rivlerësimit dhe u debatua në seancë gjyqësore publike.
17. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, u administruan denoncime nga publiku të depozituara nga denoncuesit B. M.⁸, E. H.⁹ dhe O., përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, z. G. T.¹⁰, të cilat iu vunë në dispozicion paraprakisht subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime, si dhe aktet shkresore në mbështetje të tyre, të administruara nga Kolegji në cilësinë e provës¹¹, duke kundërshtuar faktet e denoncuara nga denoncuesit. Komisioneri Publik, pas parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit mbi denoncimet, gjatë seancës gjyqësore u shpreh se denoncimet plotësojnë nga ana formale kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, por nuk përmbajnë rrethana që provojnë shkelje ligjore sipas kriterëve të rivlerësimit.
Trupi gjykues, pasi dëgjoi qëndrimet e palëve në gjykim, lidhur me denoncimet e përcjella në Kolegj, arriti në përfundimin se në përmbajtjen e tyre nuk u gjendën fakte dhe rrethana të vlefshme për të hetuar më tej, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

⁷ Sipas procesverbaleve të seancave gjyqësore të datave 26.04.2022, 20.05.2022 dhe 27.05.2022.

⁸ Denoncimi i z. B. J. M. është përcjellë në Kolegj nga Komisioneri Publik, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.06.2021.

⁹ Denoncimi i i znj. E. H. është përcjellë në Kolegj nga Komisioneri Publik, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.10.2021.

¹⁰ O. është regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 19.07.2021 dhe nr. {***} prot., datë 26.04.2022.

¹¹ Subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 26.04.2022, në funksion të parashtrimeve të tij, lidhur me denoncimet nga publiku, paraqiti aktet të cilat u administruan në cilësinë e provës, si më poshtë:

- shkresë nr. {***} prot., datë 31.03.2022, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: "Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesave të bashkuara pas shqyrtimit fillestar", bashkëlidhur Vendim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 31.03.2022, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të O.";

- shkresë nr. {***} prot., datë 13.04.2022, e Universitetit "{***}", Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: "Kthim përgjigje".

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet e ankimit që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë

18. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit është në pamundësi për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasuritë e vëna, shpenzimet e deklaruar dhe kursimet e krijuara në formën e likuiditeteve në depozita bankare dhe në cash, të deklaruar gjatë viteve të deklarimeve periodike vjetore*, trupi gjykues konstatoi si vijon.
19. Komisioni, në vendim, pas verifikimit të likuiditeteve bankare dhe në *cash* të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionet:
- Për pasurinë depozitë me vlerë 3.000.000 lekë, krijuar në datën 31.12.2014, në Alpha Bank: *Deklarimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me gjendjen cash të akumuluar jashtë sistemit bankar për vitet 2007-2014. Subjekti ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e likuiditeteve cash të deklaruar në vite, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite.*
 - Për pasurinë depozitë me vlerë 2.000.000 lekë, krijuar në datën 31.12.2015, me afat 36-mujor në ABI Bank dhe depozitë me vlerë 700.000 lekë, krijuar në datën 31.12.2016, me afat 36-mujor në po të njëjtën bankë: *Subjekti i rivlerësimit provoi bindshëm pretendimet në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve për arsye pune, si dhe mbulimin e shpenzimit në shumën 290.000 lekë me të ardhurat e prindërve. Duke i reflektuar në analizën financiare për vitet 2013-2016, ka rezultuar se për vitin 2013 analiza paraqitet pozitive, ndërsa balanca negative minimizohet për vitin 2014, në shumën prej 44.456 lekësh, për vitin 2015 në shumën 50.443 lekë dhe për vitin 2016, në shumën prej 44.449 lekësh. Për sa më sipër, u konkludua se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e depozitave në ABI Bank.*
 - Për pasurinë gjendje *cash*, me shumë 5.000 USD, të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit: *subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e gjendjes cash në datën 27.01.2017.*
 - Për pasurinë llogari kursimi, në vlerën 6.906 euro, në Intesa San Paolo Bank, në emër të vajzës së subjektit, znj. M. B.: *Komisioni analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e ligjshme nga punësimi në Greqi i vëllait A. B. dhe nga analizimi i këtyre të ardhurave, ka rezultuar se ato janë në masë të mjaftueshme për të justifikuar dhënien e kësaj shume si dhuratë dhe mbulimin e shpenzimeve jetike të tij.*
20. Komisioneri Publik ka kundërshtuar në ankim vendimin e Komisionit për sa u përket konkluzioneve të mësipërme, duke pretenduar se nga analiza financiare lidhur me të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet, i rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e tij të deklaruar ndër vite. Komisioneri Publik, në argumentimin e tij mbi këtë shkak ankimi, për periudhën 2007-2016, ka referuar diferenca negative për secilin vit, si rezultat i një analize financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve përkatëse. Në përmbledhje të këtyre rezultateve financiare të referuara, Komisioneri Publik ka pretenduar se për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet e deklaruar dhe kursimet në formën e likuiditeteve në depozitat bankare dhe në *cash* për një diferencë totale negative prej rreth 3.300.000 lekësh ose rreth 4.200.000 lekë, nëse nuk konsiderohen si të ardhura të ligjshme të ardhurat e deklaruar si dhurime.
- Subjekti i rivlerësimit, në kundërankim, pretendoi se duke mos paraqitur në ankim asnjë tabelë, asnjë sqarim për përlllogaritjet e kryera, asnjë referencë krahasuese me tabelat e analizës së Komisionit, Komisioneri Publik ia ka bërë të pamundur paraqitjen e argumenteve për kundërshtimin e konkluzioneve të tij. Në këtë mënyrë, Komisioneri Publik ka cenuar parimin

e barazisë së armëve, pasi i ka hequr mundësinë subjektit të rivlerësimit për të kundërshtuar faktet apo provat që mund jenë mbajtur parasysht në kryerjen e një vlerësimi të gabuar në ankim.

21. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut të ankimit dhe kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm¹², trupi gjykues vendosi kryerjen e një analize financiare nga Komisioneri Publik për periudhën 2003-2016, në të cilën të reflektoheshin të gjitha pretendimet e parashtruara në ankim, për t'i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të qartësohej e të mbrohej lidhur me metodologjinë e përdorur në arritjen e rezultatit financiar të pretenduar nga Komisioneri Publik, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare për shpenzimet e deklaruara dhe kursimet në formën e likuiditeteve në depozitat bankare dhe në *cash*. Analiza financiare në të cilën ishin pasqyruar edhe në mënyrë tabelare diferencat mes zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për secilin vit të periudhës 2003-2016, iu bë e njohur paraprakisht subjektit të rivlerësimit¹³ dhe u debatua nga palët në seancën gjyqësore të datës 20.05.2022. Në këtë mënyrë, trupi gjykues zgjidhi të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me cenimin e parimit të barazisë së armëve, të parashtruara në kundërankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj.
22. Komisioneri Publik, gjatë gjykimit në Kolegj, parashtrroi se *analiza financiare për subjektin e rivlerësimit, e kryer në kuadër të shkaqeve të ankimit për periudhën e deklarimit 2003-2016, për secilin vit, ka marrë në konsideratë: (i) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes sipas konfirmimeve zyrtare të institucioneve përgjegjëse, ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore dhe të ardhurat nga interesat nga llogaritë bankare; (ii) shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së; të udhëtimit sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe detajimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, bazuar në metodologjinë e Kolegjit; shpenzimet e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe ato të rezultuara gjatë hetimit administrativ; si dhe (iii) kursimet sipas lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të dhe ato të deklaruara në deklaratat periodike vjetore*¹⁴. Bazuar në rezultatet e analizës financiare, Komisioneri Publik ka konfirmuar qëndrimin e tij se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasuritë e vëna, shpenzimet e deklaruara dhe kursimet e krijuara në formën e likuiditeteve në depozita bankare dhe në *cash*, të deklaruara gjatë viteve të deklarimeve periodike vjetore, në shumën totale prej 2.793.682 lekësh.
23. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të rezultateve të analizës financiare të kryer nga Komisioneri Publik, pretendoi se *në tabelën e analizës financiare evidentohen gabime të rënda në përlllogaritje, të cilat mund të verifikohen në çdo kohë nga trupi gjykues, thjesht duke iu referuar të dhënave që rezultojnë: (i) nga llogaritë/vërtetimet bankare; (ii) nga leximi i saktë i deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike të interesave lidhur me kursimet në *cash*; si dhe (iii) nga tabela standarde e shpenzimeve të jetesës që INSTAT-i ka përcjellë në ILDKPKI*. Pas reflektimit të këtyre të dhënave në analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik, subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer prej ekspertit kontabël të zgjedhur prej tij¹⁵, i ka rezultuar se diferencat negative të konstatuara zvogëlohen ndjeshëm, për pasojë pretendimet e Komisionerit Publik janë të pabazuara.

¹² Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 26.04.2022.

¹³ Analiza financiare për vitet 2003-2016, në kuadër të shkaqeve të ankimit, u përcoll nga Komisioneri Publik në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 04.05.2022 dhe më pas iu përcoll subjektit të rivlerësimit nga Kolegji.

¹⁴ Shih paragrafin e parë, në faqen 1 të analizës financiare, të kryer nga Komisioneri Publik.

¹⁵ Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës aktet e ekspertimit të ekspertes M. N., të cilat u administruan në cilësinë e provës, përkatësisht: aktin e ekspertimit "Analizë e flukseve monetare të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura mbi pasurinë e subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Banushi", administruar në seancën gjyqësore të datës 26.04.2022; aktin e ekspertimit "Analizë e flukseve monetare të paraqitura në analizën financiare të bërë nga Komisioneri Publik në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Banushi", administruar

24. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik të përcjella nëpërmjet analizës financiare dhe në konkluzionet përfundimtare, shqyrtoi kundërshtimet e shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për to, analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe ato të administruara në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj, nën dritën e legjislacionit të zbatueshëm në rrethanat konkrete, i vlerësoi ato në raport me rezultatin e balancave vjetore negative, sipas të cilave subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme, duke arsyetuar siç shtjellohet në detaj në vijim, për vitet përkatëse.
25. *Për vitin 2007*, Komisioneri Publik pretendoi se, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave të këtij viti, nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve, rezultoi se kursimi në *cash* i deklaruar në shumën 400.000 lekë, blerja e automjetit tip “Audi A4”, së bashku me shpenzimet e vitit, nuk mbulohen me burime të ligjshme në shumën 669.294 lekë.
26. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi rezultatin e analizës së kryer nga Komisioneri Publik për vitin 2007, duke argumentuar se:
- a) Të ardhurat e tij nuk janë përllogaritur saktë, sipas të dhënave që rezultojnë nga sistemi bankar.
 - b) Në zërin e shpenzimeve familjare të jetesës, vlera prej 943.872 lekësh, e evidentuar në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve të jetesës së hartuar nga ILDKPKI-ja dhe përcjellë në Komision dhe Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019¹⁶, nuk duhej të konsiderohej si e tillë nga Komisioneri Publik dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të merret në konsideratë as nga Kolegji. Në formimin e tabelës përmbledhëse të shpenzimeve të jetesës për vitet 2003-2016, ILDKPKI-ja ka kombinuar të dhënat e dërguara nga INSTAT-i në lidhje me Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës [LSMS] për vitet 2003-2006 e 2008-2014 dhe Anketën e Buxhetit të Familjes, për vitet e tjera. Nisur nga ky fakt, nuk është aspak e logjikshme që ILDKPKI-ja të përllogariste shpenzimet e jetesës bazuar në përzierjen e dy metodologjive të ndryshme, pasi kjo krijon pikëpyetje të mëdha për sa i përket uniformitetit dhe natyrshmërisë së variablit të vlerave të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve të jetesës. Vlera e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, për familjen me 4 persona, duhet të jetë 696.288 lekë.
 - c) Gjendja e kursimeve në *cash* në fund të vitit 2006 dhe për rrjedhojë edhe në fillim të vitit 2007, nuk rezultoi të jetë 1.150.000 lekë, siç përllogaritet nga Komisioni, dhe as 700.000 lekë, siç përllogaritet nga Komisioneri Publik, por 850.000 lekë, të përllogaritura sipas formulës 400.000 lekë kursim në vitin 2006 dhe 450.000 lekë të ardhura nga shitja e automjetit tip “Nissan Patrol” në vitin 2005. Në konceptin e subjektit të rivlerësimit, gjendja *cash* në fund të vitit 2005, përfaqëson vetëm kursimet e familjes së tij, ndërsa të ardhurat në shumën 450.000 lekë, të siguruar nga shitja e automjetit në vitin 2005, nuk i konsideron si kursime, por thjesht të ardhura, të destinuar për t’u shpenzuar sërish për blerjen e një automjeti tjetër, prandaj nuk i ka përfshirë në vlerën totale të gjendjes *cash* që dispononte në fund të vitit 2005, e cila duhet të ishte deklaruar në vlerën 750.000 lekë. Shuma prej 450.000 lekësh është përfituar më datë 04.12.2005, për rrjedhojë është e logjikshme që subjekti ta ketë pasur gjendje këtë shumë edhe

në seancën gjyqësore të datës 20.05.2022; si dhe aktin e ekspertimit “Sqarime në lidhje me analizën e flukseve monetare të paraqitura në analizën financiare të bërë nga Komisioneri Publik në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Banushi, për sa u përket shpenzimeve të jetesës”, administruar në seancën gjyqësore të datës 26.05.2022.

¹⁶ *Në seancën gjyqësore të datës 20.05.2022, u administrua në cilësinë e provës, me kërkesë të trupit gjykues, shkresa nr. {***} prot., datë 04.03.2019, e përcjellë nga ILDKPKI-ja në Institutin e Komisionerëve Publikë, shkresë e cila iu vu në dispozicion subjektit të rivlerësimit në të njëjtën seancë gjyqësore. Në seancën gjyqësore të datës 26.06.2022, subjekti i rivlerësimit paraqiti shkresën nr. {***} prot., datë 20.05.2022, me lëndë “Kthim përgjigje”, me anë të së cilës Komisioni i ka vënë në dispozicion shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision. Aktet e cituara më sipër, u administruan në cilësinë e provës, në seancën gjyqësore të së njëjtës datë.*

për pjesën tjetër të muajit dhjetor. Koncepti i gabuar i tij, në lidhje me atë çka konsiderohej dhe duhet të deklarohet si gjendje *cash*, shtrihet edhe më pas në deklaratën e vitit 2006, ku ai sërish nuk e konsideron shumën e siguruar nga shitja e automjetit si pjesë të kursimeve të tij dhe që duhej të vazhdohej të deklarohet në gjendjen e mbetur *cash*. Kjo është arsyeja që në deklaratën e vitit 2006, ai deklaroi vetëm kursimet në shumën 400.000 lekë, duke menduar që deklarimi një herë i kësaj vlere ka qenë i mjaftueshëm, pra për subjektin e rivlerësimit, vlere 450.000 lekë, e siguruar nga shitja e automjetit, futet në konceptin e pasurisë së familjes, por jo në konceptin e kursimit nga të ardhurat. Duke deklaruar në deklaratën e interesave të vitit 2007 se është pakësuar e gjithë pasuria me blerjen e autoveturës tip “Audi”, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar situatën e kursimeve të tij në *cash*.

27. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të palëve në gjykim, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

27.1 Lidhur me shpenzimet e jetesës për vitin 2007, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik i ka përlloritur këto shpenzime në shumën 943.782 lekë, bazuar në të dhënat e përcjella nga ILDKPKI-ja në Institucionin e Komisionerëve Publikë, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, e njëjta shkresë që është përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision dhe në Kolegj. Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, i ka përlloritur këto shpenzime në shumën 546.480 lekë, sipas të dhënave të vitit paraardhës [2006], të referuara në shkresën e sipërcituar. Trupi gjykues vlerëson se të dhënat e pasqyruara në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve të jetesës të hartuar nga ILDKPKI-ja, janë bazuar në standardet e raportuara nga institucioni i vetëm i specializuar për statistikat – INSTAT – dhe këto vlere janë përdorur nga ILDKPKI-ja nga viti 2004 e në vijim, në ushtrimin e funksioneve të veta kontrolluese sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”)¹⁷ ndaj subjekteve deklaruese. Mënyra e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it për secilin vit të analizës financiare, përfshirë dhe vitin 2007, përbën një qëndrim të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit, jo vetëm si nevojë për ta mbështetur vendimmarrjen në të dhëna të standardizuara, dokumente dhe prova të besueshme sipas parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por edhe në mbështetje të frymës që përshkon dispozitat kushtetuese dhe që reflektohet edhe në dispozitat e ligjit të sipërcituar se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore ekzistuese, pasi është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të¹⁸.

27.2 Lidhur me gjendjen e kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit, në fund të vitit 2006 ose në fillim të vitit 2007, nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave, trupi gjykues konstatoi se ai ka filluar të deklarojë kursime në *cash*, nga viti 2005.

Në deklaratën e interesave të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

“Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Nissan Patrol”, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2005, vlere 450.000 lekë.

Gjendje *cash* e siguruar nga kursimet e të ardhurave të mia. Vlere 300.000 lekë”.

Në deklaratën e interesave të vitit 2006, ka deklaruar: “Gjendje *cash* e siguruar nga të ardhurat e mia. Vlere 400.000 lekë”.

Në deklaratën periodike të vitit 2007, ka deklaruar: “Gjendje *cash* e siguruar nga kursimet e të ardhurave të mia (shtim). Vlere 400.000 lekë”. Dhe: “Është pakësuar e gjithë pasuria me blerjen e autoveturës tip “Audi A4”, vit prodhimi 2001, blerë në Gjermani me kontratën e

¹⁷ Sipas përmbajtjes së shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019, që ILDKPKI-ja ka përcjellë në institucionet e rivlerësimit, në faqen 1, paragrafi i dytë i saj.

¹⁸ Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 44.

thjeshtë, datë 30.07.2007. Vlera: 3.800 euro, vlera e blerjes së automjetit, pasi ka qenë i guditur nga breshëri; 2.900 euro riparimi i defekteve; 231.064 lekë vlera e zhdoganimit”.

Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar: “Automjet tip “Audi”, vit prodhimi 2001, blerë sipas faturës së datës 30.07.2007. Burimi i krijimit: Nga shitja e automjetit tip “Nissan Patrol”, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2005, në vlerën 450.000 lekë, si dhe kursime familjare. Vlera: 3.800 euro sipas faturës dhe 231.064 lekë dogana”.

27.2.1 Komisioni, në tabelën e analizës financiare të pasqyruar në vendim¹⁹, ka përllogaritur se subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2006 [ose në fillim të vitit 2007] ka pasur të disponueshme, kursime *cash* në shumën 1.150.000 lekë, e rezultuar si shumatore e kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2005 e 2006 dhe shumës së deklaruar të përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2005. Për rrjedhojë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që, me burime të ligjshme, të krijonte pasuritë e të kryente shpenzimet në vitin 2007.

27.2.2 Komisioneri Publik, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, ka përllogaritur në zërin kursime në *cash*, vlerën prej 700.000 lekësh si shumatore e kursimeve të deklaruara në *cash* nga subjekti në secilën prej deklaratave të viteve 2005 e 2006, pa përfshirë të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit, ndërsa vetë subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kursimet në *cash* që ai dispononte në fillim të vitit 2006, ishin në vlerën 850.000 lekë, të përllogaritura si shumë e 400.000 lekëve kursim në vitin 2006 dhe 450.000 lekëve të ardhura nga shitja e automjetit tip “Nissan Patrol” në vitin 2005.

27.2.3 Në analizë të pretendimeve të palëve në gjykim si më sipër, në raport me të dhënat e kursimeve në *cash* të rezultuara nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave të viteve 2005 e 2006 si më sipër cituar, trupi gjykues vlerëson se në deklaratën periodike të interesave në vitin 2006, subjekti ka deklaruar gjendjen e kursimeve *cash* në banesë dhe jo shtimin e tyre, për pasojë shuma prej 400.000 lekësh ka përthithur edhe vlerën e deklaruar si kursim prej tij në shumën 300.000 lekë, në vitin 2005. Kjo mënyrë interpretimi e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit është pranuar e kërkuar edhe prej tij gjatë gjykimit në Kolegj²⁰. Për sa i përket shumës prej 450.000 lekësh, e përfituar nga shitja e automjetit tip “Nissan Patrol” në vitin 2005²¹, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo shumë është disponuar prej tij *cash* në vitin 2005 dhe në vitin 2006, për t’u përdorur më pas në vitin 2007 për blerjen e automjetit tip “Audi”, ashtu siç ka deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nuk është bindës. Shuma prej 450.000 lekësh, e deklaruar si “e ardhur” në deklaratën e vitit 2005, në kushtet kur është përfituar në fillim të muajit dhjetor 2005, është e arsyeshme të prezumohet se është disponuar deri në fund të këtij viti nga subjekti i rivlerësimit, por pretendimi i tij se këtë shumë ka vazhduar ta konsiderojë si “të ardhur” edhe në vitin 2006 dhe, për këtë arsye, nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* në këtë vit, nuk përputhet me deklaratimin periodik të vitit 2006, sipas të cilit gjendja *cash* që ai dispononte në banesë, në

¹⁹ Faqe 9 e vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit.

²⁰ Në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore të datës 20.05.2022, si dhe në konkluzionet përfundimtare në seancën gjyqësore të datës 26.05.2022.

²¹ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Sikurse kam deklaruar në deklaratën vjetore periodike të dorëzuar, autovetura e markës “Nissan”, vit prodhimi 1985, është blerë në vitin 1998, në vlerën 1.000.000 lekë, me kontributin e përbashkët të vëllait tim A. B., kontributin e prindërve të mi S. e A. B., si dhe me kontributin tim. Kontribuuesi kryesor ka qenë vëllai im A. B., i cili qysh prej vitit 1995, pra në moshën 17-vjeçare, ka emigruar si emigrant ekonomik në shtetin grek, ku është vendosur në qytetin e Athinës. [...] Kontributi i tij në blerjen e automjetit “Nissan” në vitin 1998, ka qenë në shumën 620.000 lekë dhe burimi i tyre ishin kursimet nga puna e tij në shtetin grek. Kontributi i prindërve të mi ka qenë në shumën 80.000 lekë dhe burimi i këtij kontributi ishin kursimet nga të ardhurat e realizuara nga ekonomia blegtorale, shitja ndër vite, qysh prej vitit 1992, e qengjave dhe kecape”.

shumën prej 400.000 lekësh, buronte nga të ardhurat e tij, e logjikisht këtu duhej të përfshihej edhe e ardhura e përfituar nga shitja e automjetit, pavarësisht se në këtë vit kjo shumë do të duhej të kualifikohej si “kursim”, për sa kohë nuk ishte shpenzuar si “e ardhur” gjatë vitit 2005. Edhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e tij në Kolegj, sipas të cilit shuma prej 450.000 lekësh është konceptuar si “e ardhur” në vitet 2005 e 2006 dhe si “pasuri” vetëm në momentin e pretenduar të përdorimit të saj në vitin 2007, nuk shërbeu si argument i favorshëm në drejtim të krijimit të bindjes se kjo shumë disponohej ende prej tij në fund të vitit 2006. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e vitit 2006, se gjendja *cash* e disponuar prej tij është në shumën 400.000 lekë, është deklarimi i vërtetë, i cili duhej të merrej në konsideratë në analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe nga Komisioneri Publik.

27.2.4 Për sa u përket të ardhurave të subjektit të rivlerësimit²², trupi gjykues vëren se, sipas pasqyrimin të të dhënave në analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë përlllogaritur në shumën 1.173.208 lekë, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër²³, në vlerë të njëjtë me përlllogaritjet e Komisionit në vendim. Në kuadër të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e tij duhet të ishin përlllogaritur në shumën 1.140.767 lekë, sipas të dhënave të pasqyruara në dokumentacionin bankar të përcjellë në Komision nga bankat e nivelit të dytë, trupi gjykues verifikoi dokumentacionin e sipërcituar, nga rezultoi se, sipas të dhënave bankare, subjektit të rivlerësimit, në llogarinë e pagës në Bankën Raiffeisen nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, i ka kaluar si pagë dhe shpërblime shuma prej 1.124.589 lekësh. Kjo vlerë rezulton më e ulët se ajo e përlllogaritur nga subjekti i rivlerësimit, pasi në të nuk janë përfshirë dietat, të cilat, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit²⁴, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pasi janë vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës.

27.2.5 Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioneri Publik në raport me analizën e kryer në Komision, trupi gjykues konstatoi se zëri shpenzime, udhëtime jashtë vendit, është përlllogaritur në vlerën 5.480 lekë, ndërsa nga Komisioni në vlerën 30.910 lekë. Trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit TIMS, përlllogariti shpenzimet e udhëtimit për vitin 2007, në vlerën 52.877 lekë, referuar metodologjisë së përdorur në jurisprudencën e Kolegjit, si dhe në mbështetje të faktit se nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ në Komision, nuk rezultuan akte që mund të provonin pretendimet e subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, për kosto më të ulëta udhëtimi, për shkak se ka shkuar vetëm ose familjarisht te të afërmit e tij dhe shpenzimet janë mbuluar prej tyre²⁵. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë shoqëruar me deklarata/vërtetime, nëpërmjet të cilave do të mund të deduktohej mbulimi tërësisht apo edhe pjesërisht i shpenzimeve të qëndrimit për subjektin apo bashkëshorten e tij, përgjatë periudhës së qëndrimit. Për rrjedhojë, duke qenë të pambështetura në akte dhe dokumente provuese, trupi gjykues vlerëson se përlllogaritja e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit nga Komisioneri Publik dhe nga Komisioni, bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit²⁶.

²² Nga përmbajtja e akteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, nuk ekzistojnë të dhëna në lidhje me të ardhura të realizuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2003-2007, duke rezultuar subjekti i rivlerësimit i vetmi anëtar i punësuar i familjes.

²³ Vërtetimi nr. {***} prot., datë 19.01.2017, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

²⁴ Vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019; nr. 1/2020, datë 15.01.2020; nr. 1/2020, datë 15.01.2020; nr. 18/2021, datë 12.07.2021; nr. 26/2021, datë 04.08.2021.

²⁵ Bazuar në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 të Komisionit dhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

²⁶ Vendimi nr. 11/2019 dhe vendimi nr. 27/2020 i Kolegjit.

28. Në funksion të arsytimit të mësipërm lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues kontrolloi analizën e kryer nga Komisioneri Publik për vitin 2007, duke kryer njëkohësisht edhe përditësimin e zërave të saj, sipas konkluzioneve të arritura më sipër. Nga verifikimi i kryer, rezultoi se për vitin 2007, mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit tip “Audi A4”, krijimin e kursimeve *cash* në shumën 400.000 lekë dhe kryerjen e shpenzimeve, është në shumën 1.070.739 lekë. Edhe nëse në një qëndrim garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të kryer në Kolegj, do të përfshihej në gjendjen e kursimeve në *cash* shuma prej 450.000 lekësh, e përfituar nga shitja e automjetit tip “Nissan Patrol” dhe shpenzimet e jetesës do të reduktoheshin në shumën 696.288 lekë, të pretenduar nga subjekti, përsëri rezultati do të ishte një balancë negative e burimeve të ligjshme.
29. Për vitin 2008 dhe vitin 2009, Komisioneri Publik pretendoi se, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave të këtyre viteve, nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve, rezulton se kursimet në *cash*, deklaruar në shumën 700.000 lekë në vitin 2008 dhe në shumën 800.000 lekë në vitin 2009, së bashku me shpenzimet e këtyre viteve, nuk mbulohen me burime të ligjshme, përkatësisht në shumën 130.193 lekë dhe 155.287 lekë, në ndryshim nga rezultati i analizës së kryer në Komision, sipas së cilës diferencat negative përkatëse janë 12.567 lekë për vitin 2008 dhe 755 lekë për vitin 2009.
30. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi rezultatin e analizës së kryer nga Komisioneri Publik për këto vite, duke argumentuar se të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nuk janë përlllogaritur saktë sipas të dhënave që rezultojnë nga sistemi bankar dhe kursimet në *cash* nuk janë përlllogaritur sipas deklaratimit të tij në deklaratimet periodike përkatëse.
31. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të palëve në gjykim, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

31.1 Për sa u përket të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se, sipas pasqyrimit të të dhënave në analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë përlllogaritur në vlerë të njëjtë me përlllogaritjet e Komisionit në vendim, në shumën 1.200.540 lekë në vitin 2008 dhe 1.241.532 lekë në vitin 2009, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër²⁷, ndërsa të ardhurat e bashkëshortes janë përlllogaritur në shumën 107.168 lekë për vitin 2008 dhe 233.246 për vitin 2009, bazuar në vërtetimin “Për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, të Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjyrokastër”. Në kuadër të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e tij duhet të ishin përlllogaritur në shumën 1.295.137 lekë për vitin 2008 dhe 1.359.137 lekë për vitin 2009, sipas të dhënave të pasqyruara në dokumentacionin bankar të përcjellë në Komision nga bankat e nivelit të dytë, trupi gjykues verifikoi dokumentacionin e sipërcituar, nga rezultoi se sipas të dhënave bankare, subjektit të rivlerësimit, në llogarinë e pagës në Bankën Raiffeisen, nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër i ka kaluar si pagë dhe shpërblime shuma prej 1.191.455 lekësh për vitin 2008 dhe shuma prej 1.239.937 lekësh për vitin 2009. Kjo vlerë rezulton më e ulët se ajo e përlllogaritur nga subjekti i rivlerësimit, pasi në të nuk janë përfshirë dietat, të cilat, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, por si mbulim i shpenzimeve të kryera për shkak të ushtrimit të detyrës.

Në kuadër të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e bashkëshortes së tij duhet të ishin përlllogaritur në shumën 162.638 lekë për vitin 2008 dhe 271.686 lekë për vitin 2009, sipas të dhënave të pasqyruara në dokumentacionin bankar të përcjellë në Komision nga bankat e nivelit të dytë, trupi gjykues verifikoi dokumentacionin e sipërcituar, nga rezultoi se, sipas të

²⁷ Vërtetimi nr. {***} prot., datë 19.01.2017, i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër.

dhënave bankare, znj. M. B., në llogarinë e pagës në bankën Intesa San Paolo, i kanë kaluar si pagë shumat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit.

31.2 Për sa u përket kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në këto vite, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik, në fund të vitit 2008 ka përllogaritur si gjendje *cash* shumën prej 700.000 lekësh, nisur nga fakti se nga analiza financiare e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të mbuluar shumën e deklaruar të kursyer, 400.000 lekë, për rrjedhojë kjo shumë nuk është konsideruar si gjendje e mbartur *cash* për vitin 2008. Për vitin 2009, gjendja e kursimeve në *cash* është përllogaritur e shtuar në shumën 800.000 lekë, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave të këtij viti. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë përllogaritje të Komisionerit Publik, duke pretenduar se gjendja e kursimeve në *cash* duhet të jetë e njëjtë me atë të përllogaritur nga Komisioni. Në fund të vitit 2008, kjo gjendje është në shumën e akumuluar prej 1.100.000 lekësh, e rrjedhur nga 400.000 lekë në fund të vitit 2007 dhe 700.000 lekë shtesë në vitin 2008. Ndërsa për vitin 2009, shuma e kursimeve në *cash* si pasojë e shtesës vjetore prej 800.000 lekësh, arrin shumën 1.900.000 lekësh.

Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues, pasi verifikoi deklaramit e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave të viteve 2008 dhe 2009, vlerësoi se kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat lidhen me gjendjen e akumuluar të kursimeve në *cash*, nuk janë të bazuara, pasi edhe nga rezultati i analizës financiare të kryer në Kolegj, rezultoi se ai nuk kishte burime financiare të ligjshme për të krijuar shumën prej 400.000 lekësh, e deklaruar si kursim *cash* në vitin 2007. Për pasojë, kjo shumë nuk mund t'u shtohet kursimeve të akumuluar, të deklaruara në vitet pasardhëse.

31.3 Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioneri Publik në raport me analizën e kryer në Komision, trupi gjykues konstatoi se Komisioneri Publik, në zërin shpenzime, udhëtime jashtë vendit, ka përllogaritur vlerën 6.190 lekë për vitin 2008 dhe 80.707 lekë në vitin 2009, ndërsa Komisioni vlerën 23.351 lekë për vitin 2008 dhe 57.562 lekë për vitin 2009. Trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit *TIMS* dhe deklaramit të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision për udhëtimet e kryera, përllogariti shpenzimet e udhëtimit në shumën 77.736 lekë për vitin 2008 dhe në shumën 262.478 lekë për vitin 2009, mbështetur në të njëjtën metodologji dhe arsyetim të përdorur në paragrafin 27.3.5 të këtij vendimi.

32. Në funksion të arsytimit të mësipërm, trupi gjykues kontrolloi analizën e kryer nga Komisioneri Publik për vitet objekt shqyrtimi, duke kryer njëkohësisht edhe përditësimin e zërave të saj, sipas konkluzioneve të arritura më sipër. Nga verifikimi i kryer, rezultoi se mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 700.000 lekë në vitin 2008 dhe në shumën 800.000 lekë në vitin 2009, si dhe për kryerjen e shpenzimeve, për këto vite, është përkatësisht në shumën 154.813 lekë për vitin 2008 dhe 169.580 lekë për vitin 2009.

33. Për vitin 2013, Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se prindërit e tij kanë mbuluar shpenzimet në shumën 290.000 lekë për udhëtimin në Angli të vajzës së tij. Këtë shpenzim dhe njëkohësisht të ardhur si dhuratë nga prindërit, subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013 dhe as në pyetësorin nr. 1 të Komisionit. Sipas Komisionerit Publik, nëse këto të ardhura nuk do të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, analiza financiare e vitit 2013 do të rezultonte me diferencë negative në shumën 148.770 lekë.

33.1 Në kundërshtim të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se në traditën shqiptare është e paimagjinueshme që në një familje normale,

gjyshërit, të cilët kanë mundësi ekonomike, të mos japin në raste të veçanta dhurata monetare për nipërit dhe mbesat e tyre. Për këtë arsye, nuk është normale që në analizën financiare, këto dhurata në vlerë monetare të konsiderohen zero, vetëm për faktin që në lidhje me këto dhurata, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë, përveçse deklaratës noteriale të familjarit që ka bërë dhurimin. Në rastin konkret, vlera e dhurimit prej 290.000 lekësh është më se normale dhe më se e përballueshme nga të ardhurat/kursimet e prindërve të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar vlerën e dhuruar, pasi ajo ka qenë nën vlerën 300.000 lekë. Në rast se në analizën financiare të Komisionit Publik do të reflektoheshin vlerat e sakta monetare të siguruara nga të dhënat bankare në lidhje me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, edhe nëse nuk do të konsiderohej shuma 290.000 lekë si dhurim, balanca negative e vitit 2013 do të ishte në një vlerë të papërfillshme prej 76.439 lekësh.

34. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të pasqyruara më sipër nga palët në gjykim, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi si vijon.

34.1 Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhurata në vlerën mbi 10.000 lekë, sipas kërkesës së formularit të deklarimit të interesave privatë.

34.2 Në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit, përcjellë në këtë të fundit më datë 19.02.2018, pyetjes së Komisionit: *A keni marrë ndonjë dhuratë me vlerë mbi 500 euro apo ka financuar dikush një shpenzim për llogarinë tuaj në një shifër më të lartë se kjo shumë në shtatë vitet e fundit (respektivisht 2011-2017)?* – subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: *Nuk kam marrë asnjë dhuratë me vlerë mbi 500 euro dhe askush nuk ka financuar një shpenzim për llogarinë time.*

34.3 Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit kërkesën: *Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se, nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 26.04.2013, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., prindërit tuaj kanë deklaruar se kanë sponsorizuar me shpenzimet e tyre për vajzën tuaj, udhëtimin dhe gjithçka tjetër, për një udhëtim në Angli [...]. Ju lutem, na informoni mbi shumën e kontribuar nga prindërit tuaj dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për këtë sponsorizim.*

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje ka deklaruar: *Shuma e sponsorizuar nga prindërit e mi për udhëtimin e vajzës sime M. B. në Angli, në qendrën “{***}”, në vitin 2013, ka qenë në vlerën 290.000 lekë ose 1.800 GBP (paund). Burimi i kësaj shume kanë qenë të ardhurat e realizuara nga ekonomia bujqësore, bletaria e vreshtaria, e zhvilluar prej tyre në fshatin {***}/Gjirokastër, si dhe nga kursimet e grumbulluara prej tyre ndër vite.*

Bashkëlidhur përgjigjeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2019, të babait të tij, z. S. B., i cili deklaroi se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në një shkollë verore në Angli, ia kanë siguruar ata mbesës së tyre, pasi kishin mundësi të përballonin shumën 1.800 paund ose 290.000 lekë që nevojitej, jo vetëm si shenjë dashurie ndaj saj, por edhe si shenjë falënderimi për djalin e tyre Dritan Banushi, i cili u ka qëndruar pranë gjithë jetën.

34.4 Bazuar në referimin e Komisionit në pyetësor, se në dokumentacionin e administruar në dosje gjendet deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.04.2013, trupi gjykues verifikoi dokumentacionin e sipërcituar, nga ku rezultoi se si pasojë e hetimit të Komisionit, noteri B. Xh. ka përcjellë aktet mbi veprimet noteriale të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ndër të cilat edhe deklaratën noteriale të sipërcituar të z. S. B. [babai i subjektit të rivlerësimit] dhe znj. A. B. [nëna e subjektit të rivlerësimit], të cilët deklarojnë se: *Sponsorizojmë e garantojmë me shpenzimet tona për shpenzimet në udhëtim e*

*gjithçka tjetër të mbesës sonë të quajtur M. B. [...], për të shkuar në shtetin e Anglisë, në qendrën “{***}”, në pushime verore nga data 23 qershor 2013 e në vazhdim.*

35. Duke analizuar pretendimin e Komisionerit Publik, se shuma prej 290.000 lekësh nuk duhet të konsiderohet si e ardhur e ligjshme për shkak se nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave të vitit 2013 dhe as në pyetësonin nr. 1 të Komisionit, në raport me situatën faktike të pasqyruar si më sipër, trupi gjykues vëren se sipas nenit 4, shkronja “f” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjektet deklaruese detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, lidhur me dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale, me përjashtim të rastit kur vlera e dhuratës ose trajtimit preferencial është më e vogël se 10.000 lekë.

Bazuar në përcaktimin ligjor si më sipër, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të interesave për vitin 2013, kishte detyrimin të deklaronte në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”, shumën prej 290.000 lekësh, dhuruar nga prindërit e tij për përballimin e shpenzimeve të udhëtimit të vajzës së tij në Angli. Pavarësisht nga sa më sipër, ajo që është me vlerë të nënvizohet në rastin konkret, është fakti që deklarata periodike e interesave e vitit 2013, nuk është dokumenti i vetëm provues²⁸ në lidhje me të ardhurat e fituara dhe shpenzimet e kryera nga subjekti gjatë këtij viti, pasi ekzistenca e deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.04.2013, e z. S. B. dhe znj. A. B. [prindërit e subjektit], provon dhurimin e shumës 290.000 lekë mbesës së tyre, pasi është një akt i hartuar jo gjatë dhe për efekt të provimit të fakteve në procesin e rivlerësimit, por i hartuar në kohën e kryerjes së veprimit të dhurimit, duke krijuar bindjen mbi vërtetësinë e këtij veprimi juridik.

36. Në vijim të sa më sipër, shumën prej 290.000 lekësh, trupi gjykues vlerësoi t’ia nënshtrojë testit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj, në zbatim të përcaktimit të shprehur të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit personat e tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, nëse konfirmojnë këtë marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së dhuruar.

Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit provoi bindshëm pretendimet në lidhje me [...] mbulimin e shpenzimit në shumën 290.000 lekë me të ardhurat e prindërve*²⁹.

36.1 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision dhe në kundërankim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se si burim për dhurimin në shumën 290.000 lekë, kanë shërbyer kursimet e prindërve të tij nga të ardhurat nga pensioni, deri në vitin 2012, të cilat janë në shumën totale 1.225.945 lekë, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga ekonomia bujqësore, bletaria dhe vreshtaria, për periudhën 1991-2002, në vlerë *neto* 4.496.120 lekë. Gjatë gjykimit në Kolegj, për sa u përket të ardhurave të realizuara nga ekonomia bujqësore, subjekti i rivlerësimit, bazuar në aktin e ekspertimit të datës 19.04.2022, i hartuar nga eksperti financiar i zgjedhur prej tij, ka pretenduar se pas vitit 1993 deri në fund të vitit 2002, bazuar në një nivel minimal të ardhurash prej 8.000 lekësh në muaj si familje, për të cilat, sipas legjislacionit tatimor të kohës, nuk paguhej detyrim tatimor, të ardhurat e vlerësuara të prindërve të tij janë në shumën 880.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se të ardhurat në fshat u referohen të ardhurave *neto*, për sa kohë që kostot e jetesës janë të parat që plotësohen nga fermeri dhe më pas ai shet produktet te të tretët³⁰.

²⁸ Sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

²⁹ Paragrafi 2.7 i vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit.

³⁰ Në mënyrë më të detajuar shpjegimet e subjektit për të ardhurat e prindërve të tij, gjenden në paragrafin 51.3 të këtij vendimi.

36.2 Në verifikim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e realizuara nga prindërit e tij për periudhën 1993-2002, trupi gjykues vlerësoi se ato do të konsiderohen në shumën 880.000 lekë, sa ka pretenduar subjekti gjatë gjykimit në Kolegj, bazuar në arsyetimin e shtjelluar në paragrafët në vijim të këtij vendimi, në trajtimin e shkakut të ankimit lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 85,5 m², në përdorim të subjektit të rivlerësimit e në pronësi të babait të tij.

Bazuar në dokumentacionin e administruar në Kolegj³¹, të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së prindërve, nga data e fillimit të trajtimit me pension të plotë pleqërie³² deri në datë 31.05.2013 kur është kryer dhurimi, rezultojnë të jenë në vlerën prej 1.492.869 lekësh. Në të ardhurat e z. S. B. u përllogaritën dhe të ardhurat e përfituara prej tij në shumën 55.134 lekë, si kryetar i Kryesisë së fshatit {***}³³. Të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1993 - maj 2013, janë në vlerën totale prej 2.372.869 lekësh.

Në verifikimin e mundësisë së prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumëve 290.000 lekë me burime të ligjshme, trupi gjykues konsideroi si shpenzime shumë prej 1.931.921 lekësh, e paguar nga babai i subjektit të rivlerësimit për blerjen në vitin 2003, rikonstrukcionin dhe mobilimin e apartamentit me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë, si dhe shumën 80.000 lekë si kontribut i z. S. B. në blerjen e automjetit tip “Nissan Patrol” në vitin 1998.

36.3 Me qëllimin për të përmbushur detyrimin ligjor për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e kontrollit të pasurive, duke aplikuar çdo skenar të mundshëm garantist, në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, analizën financiare për verifikimin e mundësisë së prindërve të subjektit të rivlerësimit për të krijuar shumëve 290.000 lekë, dhuruar mbesës së tyre, trupi gjykues vlerësoi ta kryejë në dy versione. *Sipas versionit të parë* të analizës financiare, në të cilin shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT, për periudhën 2000-2013, dhe sipas jurisprudencës së Kolegjit³⁴ për periudhën 1993-1999, në vlerën³⁵ totale 3.930.204 lekë, prindërit e subjektit të rivlerësimit, në maj të vitit 2013 rezultojnë me një balancë negative të të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën 2.193.266 lekë.

36.4 Ndërsa në versionin e dytë të analizës, shpenzimet e jetesës së prindërve të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993-2002, u përllogaritën në vlerën 0 lekë, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e përfituara kanë qenë “të ardhura neto”, pasi prindërit e tij kanë jetuar në fshat dhe kanë siguruar vetë produktet bujqësore e blegtorale. Për periudhën 2003-2013, shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së bazuar në INSTAT, të reduktuara në masën 50%, bazuar në pretendimet e subjektit se prindërit e tij, shpenzimet për ushqim, i kanë përballuar nga ekonomia bujqësore e blegtorale. Edhe në këtë version të analizës, prindërit e subjektit të rivlerësimit, në maj të vitit 2013 rezultojnë me një balancë negative të të ardhurave dhe shpenzimeve, por në shumën 1.295.850 lekë.

Nga sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kishin mundësi që me burime të ligjshme financiare, t’i dhuronin mbesës së tyre, znj. M. B., shumëve prej 290.000 lekësh.

³¹ Sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 07.01.2020, dhe nr. {***} prot., datë 07.01.2020, të DRSSH, Gjirokastrë, të cilat janë vërtetime mbi të ardhurat nga pensioni për z. S. B. dhe znj. A. B.

³² Pensioni i pleqërisë për znj. A. B. ka filluar në qershor 2004, ndërsa për z. S. B. ka filluar në prill 2007.

³³ Sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 15.04.2022, të Bashkisë {***}, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe e administruar si provë në Kolegj në seancën gjyqësore të datës 26.04.2022.

³⁴ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2021, datë 18.06.2021.

³⁵ Shuma prej 3.930.204 lekësh përbëhet nga: 3.350.944 lekë për periudhën 2000-2013 dhe 579.260 lekë për periudhën 1993-1999.

37. Në funksion të shqyrtimit të pretendimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues, pasi vëren se në analizën financiare të kryer prej tij për vitin 2013, shpenzimet e udhëtimit të vajzës së subjektit të rivlerësimit në Angli, janë përlllogaritur se janë përballuar nga burimet/të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se kjo mënyrë përlllogaritjeje deformon burimin e financimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për kryerjen e këtij shpenzimi objekt shqyrtimi, duke sjellë një rezultat jorealit të analizës financiare, jo në përputhje me faktet e rrethanat e konstatuara dhe me qëllimin e kontrollit të kriterit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës e neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016.
38. Në një qëndrim garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në kontroll të analizës financiare të kryer nga Komisioneri Publik për vitin 2013, me përditësimin e zërave të saj sipas konkluzionit të arritur më sipër në paragrafin 36.4 të këtij vendimi e duke pasqyruar në të, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij sipas të dhënave të përcjella në Komision nga bankat e nivelit të dytë, rezultoi se ai gjendet, sërish, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në shumën 144.658 lekë. Nëse në këtë analizë financiare, shuma prej 290.000 lekësh do të konsiderohej si e dhuruar, rezultati financiar do të ishte pozitiv, çka do të thotë që moskonsiderimi i kësaj shume si e krijuar me burime të ligjshme, afekton këtë rezultat. Por vlera negative e analizës financiare të kryer në Kolegj [por edhe nga Komisioneri Publik] rezulton në shumën prej 144.658 lekësh, për shkak se analiza është kryer për të gjithë vitin, kur në fakt shpenzimi është kryer në maj të vitit të analizuar. Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit në vitin 2013, është në shumën 290.000 lekë.
39. *Për vitin 2014*, Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se ka mospërputhje mes deklarimit të bërë nga vajza e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2014 për vlerat 3.500 euro dhe 100.000 lekë, si shuma të dhuruara për fillimin e shkollës së lartë e njëkohësisht si shuma të disponuara *cash* në fund të këtij viti, me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhënë gjatë hetimit administrativ dhe, për rrjedhojë, nëse këto shuma nuk merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme, rezulton se për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për një diferencë negative prej rreth 564.959 lekësh³⁶, por në rast të kundërt rezultati i analizës financiare do të ishte pozitiv.
- Subjekti i rivlerësimit në kundërankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se për të ardhurat e evidentuara në vitin 2014, në vlerën 590.385 lekë, të cilat përfaqësojnë dhuratat në vlerë monetare që të afërmit i kanë dhënë vajzës së subjektit për 18 vite me radhë në raste të ndryshme familjare, duhet theksuar fakti që: (i) deklarimi i ekzistencës së këtyre dhuratave në vlerë monetare është bërë nga subjekti që në deklaratën e vitit 2014, në një kohë që ende nuk ishte iniciuar procesi i rivlerësimit; si dhe (ii) ekzistenca e këtyre dhuratave në vlerë monetare vërtetohet edhe nga fakti që këto dhurata janë derdhur më pas nga vajza e tij në llogarinë e saj bankare.
40. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimi i Komisionerit Publik lidhet me mospërputhje të konstatuara mes shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhënë gjatë hetimit administrativ në Komision dhe deklarimeve të vajzës së tij në deklaratën e vitit 2014, arsye për të cilën ai konsideron se këto shpjegime mbeten në nivel deklarativ, e për pasojë vë në dyshim ligjshmërinë e shumave të dhuruara.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe në analizë të pretendimeve të palëve në gjykim, trupi gjykues konstatoi si vijon.

³⁶ Kjo vlerë është përlllogaritur duke zbritur shumën 590.490 lekë nga rezultati prej 25.531 lekësh i analizës financiare të Komisionerit Publik, për vitin 2014.

40.1 Në deklaratën e rivlerësimit, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, vajza e tij, znj. M. B., ka deklaruar çeljen e llogarive të kursimit në bankën Intesa San Paolo në vitin 2015, me burim krijimi nga shuma të rrjedhura si dhuratë nga të afërmit *me rastin e fitimit të shkollës së lartë në Universitetin {***} “{***}”*.

40.2 Në deklaratën periodike të vitit 2014, znj. M. B. ka deklaruar: *Gjendje cash e rrjedhur si dhuratë nga të afërmit me rastin e fitimit të shkollës së lartë në Universitetin {***} “{***}”*. Vlera: 3.500 euro. 100.000 lekë.

41. Në përgjigjet e pyetësorit të drejtuar nga Komisioni³⁷, kërkesës: *Lidhur me dhurimet e bëra, kërkojmë informacion të detajuar lidhur me të afërmit që kanë kryer dhurime vlerash monetare në favor të vajzës suaj, si edhe mbi burimin e këtyre të ardhurave, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: Lidhur me shumat prej 3.500 eurosh dhe 100.000 lekësh, sqaroj se përshkrimi i dhënë për shumat e mësipërme prej vajzës në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 [...] është një përshkrim jo i formuluar saktë prej saj, i bërë në mungesë të njohurive në këtë fushë, në kushtet e qenies deklaruese për herë të parë, si dhe në kushtet e plotësimit të kësaj deklarate kur ajo ka qenë me sezon provimesh, në mars 2014. [...] Shumat prej 3.500 eurosh dhe 100.000 lekësh janë produkt i dhuratave monetare bërë vajzës për evente të ndryshme (datëlindje, fillim shkolle, pagëzim, ditë emri etj.), prej meje, bashkëshortes sime, familjarëve, të afërmve e shoqërisë, qysh prej lindjes së vajzës në vitin 1996, të akumuluar përgjatë 18 viteve prej saj në arkën personale të kursimit (arkë kursimi për fëmijë), të cilën e hapi me rastin e përvjetorit të 18-të të lindjes, më 23.06.2014 [...] moment që përkoi me përfundimin e arsimit të mesëm prej saj, e vendosi ta hapte arkën e saj të kursimit, me qëllim që shumën e grumbulluar në të ta depozitonte për ta përdorur si investim për arsimin e lartë. Për shkak të shtrirjes në kohë të procesit të akumulimit, kohës që ka kaluar, si dhe numrit të madh të personave dhurues, nuk jam në gjendje të kujtoj dhe përcaktoj saktë të gjithë personat konkretë dhe as të individualizoj shumat e rastet konkrete për secilin person. Burimi i këtyre të ardhurave për dhuruesit ishin të ardhurat nga puna dhe kursimet.*
42. Nga situata faktike e pasqyruar si më sipër, trupi gjykues vëren se burimi i krijimit të shumave në cash prej 3.500 eurosh e 100.000 lekësh, si në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe në deklaratimet të vajzës së tij në formularin e deklaratimit të interesave e në deklaratën e rivlerësimit, mbetet i njëjtë – dhurime nga të afërmit – por nëse vajza e subjektit i deklaroi ato të dhuruara gjatë vitit 2014, subjekti pretendon se ato janë shuma të dhuruara në një periudhë të gjatë kohore, të ruajtura prej 18 vitesh në “arkën personale të kursimit” të vajzës së tij dhe, për këtë arsye, e ka të pamundur të individualizojë të afërmit dhurues, si dhe shumat e dhuruara nga secili prej tyre.
- Trupi gjykues vlerëson se evidentimi i vitit 2014, si viti i krijimit të shumës prej 590.490 lekësh³⁸ nga dhurimet në cash, është një element që ndikohet nga deklaratimet e vajzës së subjektit të rivlerësimit në dy deklaratat, atë të vitit 2014 dhe atë të rivlerësimit, deklaratat të cilat kanë cilësinë e provës në këtë proces, bazuar në nenet 30 dhe 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se deklarimi i vajzës së tij në deklaratën e vitit 2014 ka qenë një përshkrim jo i formuluar saktë prej saj, i bërë në mungesë të njohurive në këtë fushë, në kushtet e qenies deklaruese për herë të parë, si dhe në kushtet e plotësimit të kësaj deklarate kur ajo ka qenë me sezon provimesh, por nuk ka shpjeguar përse ka lejuar të përsëritej kjo pasaktësi edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, kur vajza e tij ishte subjekt deklarues në ILDKPKI për të disatën herë, e për më tepër kur duhej treguar një kujdes i shtuar në deklarim, jo vetëm prej vajzës, por edhe prej vetë subjektit të rivlerësimit, për shkak të rëndësisë së procesit të rivlerësimit. Pretendimi i subjektit se këto shuma janë krijuar në një

³⁷ Në përgjigjet e pyetjes 3.ii të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, drejtuar subjektit të rivlerësimit më datë 04.02.2019.

³⁸ Llogaritur sipas kursit të këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, në fund të vitit 2014.

periudhë të gjatë kohore, nuk gjen mbështetje as në deklaratimet e tij të interesave ndër vite, në të cilat nuk ka deklaruar shuma të dhuruara nga të afërmit, megjithëse sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, kishte detyrimin të deklaronte vit pas viti, shumat e dhuruara me vlerë mbi 10.000 lekë. Edhe mënyra e deklaratimit të vajzës së subjektit të rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit dhe në atë periodike, deklarime të cilat kanë vlerën e provës në këtë proces, bazuar në nenet 30 dhe 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, lë hapësirë për të besuar se dhurimet kanë qenë nga disa persona të afërm apo familjarë, dhurime që së bashku kanë krijuar vlerën prej 3.500 eurosh e 100.000 lekësh.

43. Në kushtet kur gjatë hetimit në Komision, por edhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues lidhur me dhuruesit, konfirmimin prej tyre të dhurimit dhe burimin e krijimit të këtyre dhurimeve në përmbushje të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues u gjend në pamundësi për të verifikuar nëse këto shuma janë krijuar nga burime të ligjshme, shuma të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurive në formën e depozitave bankare, në vitin 2015.

Për sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se pretendimi i Komisionerit Publik se këto shuma nuk duhen konsideruar të krijuara nga burime të ligjshme, është i drejtë, pasi nëpërmjet deklaratimeve kontradiktore për kohën e krijimit të shumave që i janë dhuruar vajzës së tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për deklarim të plotë e të saktë, duke mos mundësuar kontrollin për krijimin e likuiditeteve në *cash* në shumën 590.490 lekë dhe arritjes së një përfundimi lidhur me mundësinë e krijimit të tyre me burime të ligjshme, në kushtet kur këto shuma kanë shërbyer si burim krijimi për pasuri të tjera në formën e depozitave bankare. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se balanca negative e vitit 2014, është në shumën 590.490 lekë, e rezultuar nga kontrolli i burimit të financimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit për krijimin e depozitave bankare në emër të vajzës së tij.

44. Në një qëndrim garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në kontroll të analizës financiare të kryer nga Komisioneri Publik për vitin 2014, me përditësimin e zërave të saj sipas konkluzionit të arritur më sipër në paragrafin 41 të këtij vendimi e duke pasqyruar në të të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij sipas të dhënave të përcjella në Komision nga bankat e nivelit të dytë, e duke mos e konsideruar shumën e dhuruar prej 590.490 lekësh si të ardhur, por vetëm si kursim të realizuar nga të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij, rezultoi se ai gjendet, sërish, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1.000.000 lekë³⁹, si dhe kryerjen e shpenzimeve, për vitin 2014, në shumën 564.959 lekë. Nëse në analizën financiare të këtij viti, do të korrektoheshin shpenzimet e udhëtimit të përllogaritura nga Komisioneri Publik sipas jurisprudencës së Kolegjit, bazuar në të dhënat e administruara në Komision nga sistemi TIMS dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, rezultati negativ do të thellohej në shumën 768.949 lekë⁴⁰.

45. Trupi gjykues nënvizon se mban të njëjtin qëndrim edhe për shumën 82.776 lekë [450 euro dhe 21.000 lekë] në *cash*, të deklaruar nga vajza e subjektit të rivlerësimit në vitin 2015, me burim krijimi “*dhuratë nga të afërmit për festat e fundvitit dhe ditëlindje*”, si dhe për shumën 25.000 lekë në *cash* të deklaruar në vitin 2016, me burim krijimi “*dhuratë nga të afërmit me rastin e festës së Shën Mërisë*”, të cilat kanë shërbyer për shtimin e depozitave bankare në emër të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilat i konsideron si shuma të krijuara nga burime të paidentifikuara e, për pasojë, me burime jo të ligjshme, në kuptim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

³⁹ Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje *cash* e siguruar nga kursimet e të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes, shtim. Vlera 1.000.000 lekë”.

⁴⁰ Shih arsyetimin e bërë në paragrafin 27.2.5 të këtij vendimi, lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit.

46. Për sa i përket shumës prej 3.000 eurosh, të deklaruar nga vajza e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016, si: *dhuratë nga xhaxhai im A. B., më datë 02.08.2016*, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi se:
- (i) nga verifikimi i nxjerrjes së gjendjes së llogarisë në euro të znj. M. B. në Bankën Intesa San Paolo, evidentohet se z. A. B. ka depozituar *cash*, shumën 3.000 euro, në datën 02.08.2016⁴¹;
 - (ii) me anë të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., z. A. B. deklaroi se ka depozituar shumën 3.000 euro në llogarinë e znj. M. B., mbesës së tij, në formë dhurate me rastin e ditëlindjes dhe ndjekjes ë studimeve të larta në mjekësi;
 - (iii) subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin e “Autoritetit të Pavarur të të Ardhurave Publike” në shtetin grek, mbi të ardhurat e krijuara nga z. A. B. dhe bashkëshortja e tij, të cilat janë në vlerë të konsiderueshme, si dhe detyrimet tatimore të paguara mbi këto të ardhura.
- Trupi gjykues vlerëson se situata faktike e sipërcituar përmbush kriterin e konfirmimit të marrëdhënies së dhurimit sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe personi tjetër i lidhur justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 3.000 eurosh, dhuruar vajzës së subjektit të rivlerësimit, duke u depozituar në llogarinë e saj bankare, konkluzion i cili kënaq kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
47. Për vitet 2015 dhe 2016, Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar krijimin e depozitave bankare, kursimeve në *cash* dhe shpenzimeve, përkatësisht në vitin 2015 në shumën 822.512 lekë dhe në vitin 2016 në shumën 867.626 lekë⁴².
48. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi rezultatin e analizës së kryer nga Komisioneri Publik për këto vite, duke argumentuar se të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nuk janë përlllogaritur saktë sipas të dhënave që rezultojnë nga sistemi bankar dhe likuiditetet nuk janë përlllogaritur sipas deklaramit të tij në deklaratimet periodike përkatëse. Referuar analizës financiare të kryer nga eksperti kontabël i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit dhe paraqitur prej tij e administruar në cilësinë e provës në Kolegj⁴³, në rast se zërat e kundërshtuar në analizën e Komisionerit Publik do të pasqyroheshin saktë, atëherë rezultati, për vitet 2015 e 2016 do të dilte pozitiv.
49. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe në analizë të pretendimeve të palëve në gjykim, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaratat periodike të interesave për vitet 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

⁴¹ Referuar informacionit të përcjellë në Komision nga Banka Intesa San Paolo, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2018.

⁴² Kjo vlerë rezulton nëse në analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik, gjendja e kursimeve vjetore në *cash*, në fund të vitit 2016, përlllogaritet në shumën 300.000 lekë, bazuar në pretendimet e Komisionerit Publik në konkluzionet përfundimtare, në të cilat është shprehur: “Bazuar në prapësimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, në seancat e datës 26.04.2022 dhe 20.05.2022, Komisioneri Publik vlerëson të marrë në konsideratë vetëm pretendimet lidhur me kursimet *cash* të vitit 2016, duke i konsideruar ato në vlerën 300.000 lekë në fund të këtij viti (1.000.000 lekë kursim të deklaruar të vitit i zbrësim shumën 700.000 lekë të deklaruar si të depozituar në Bankën Amerikane të Investimeve”.

⁴³ Akti i ekspertimit “Sqarime në lidhje me analizën e flukseve monetare të paraqitura në analizën financiare të bërë nga Komisioneri Publik në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Banushi, për sa u përket shpenzimeve të jetesës”, administruar në seancën gjyqësore të datës 26.05.2022.

49.1 Në deklaratën periodike të vitit 2015:

Gjendje cash e siguruar nga kursimet e të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes (shtim). Vlera: 1.100.000 lekë.

*Depozitë me afat në Alpha Bank, krijuar më 20.03.2015, me nr. reference depozite {***} dhe e mbyllur para afatit më 31.12.2015. Vlera 1.500.000 lekë. Burimi i krijimit: pakësim i gjendjes cash jashtë sistemit bankar, të deklaruar ndër vite nga pagat e të dy bashkëshortëve për periudhën 1994-2015.*

*Depozitë me afat në Bankën Amerikane të Investimeve ShA, krijuar më 31.12.2015, me nr. llogarie {***}. Vlera: 2.000.000 lekë. Burimi i krijimit: 1.500.000 lekë nga mbyllja e depozitës me nr. reference {***} dhe 500.000 lekë nga pakësimi i gjendjes cash jashtë sistemit bankar, të deklaruar ndër vite nga pagat e të dy bashkëshortëve për periudhën 1994-2015.*

[...]

Pakësuar pasuria e gjendjes cash jashtë sistemit bankar, të deklaruar ndër vite nga pagat e të dy bashkëshortëve për periudhën 1994-2015, me shumën 4.366 euro, shpenzime për arsimimin e vajzës.

49.2 Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti ka deklaruar:

Shtuar gjendja cash jashtë sistemit bankar, gjithsej në shumën 1.000.000 lekë, nga kursimet e të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes, nga të cilat shuma prej 700.000 lekësh është depozituar në Bankën Amerikane të Investimeve më 31.12.2016.

*Depozitë me afat në Bankën Amerikane të Investimeve ShA, krijuar më 30.12.2016, me nr. llogarie {***}. Burimi i krijimit: nga pakësimi i gjendjes cash jashtë sistemit bankar, të deklaruar ndër vite, si dhe nga kursimet për vitin 2016.*

[...]

Pakësuar pasuria e gjendjes cash jashtë sistemit bankar, të deklaruar ndër vite nga pagat e të dy bashkëshortëve për periudhën 1994-2015, me shumën 4.364 euro, shpenzime për arsimimin e vajzës, veprim i kryer në Intesa San Paolo Bank, më 30.09.2016.

- 50.** Trupi gjykues vëren se në analizën financiare për vitin 2015, kursimet vjetore në cash të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik i ka përlllogaritur në shumën 1.100.000 lekë, si gjendje në fund të vitit 2015, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo shumë është përdorur gjatë vitit 2015, si burim krijimi për pasuritë e deklaruar. Trupi gjykues konstatoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit përputhet me deklarin e tij në deklaratën periodike të interesave të vitit 2015, sipas të cilit, për krijimin e depozitave dhe kryerjen e shpenzimeve për shkollimin e vajzës së tij, burimi financiar ka qenë *pakësimi i gjendjes cash jashtë sistemit bankar, të deklaruar për periudhën 1994-2015*. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në mënyrë të pasaktë e ka deklaruar shumën 1.100.000 lekë si gjendje cash në datën 31.12.2015, ndërkohë që e kishte përdorur atë dhe nuk duhej ta deklaronte si të tillë, referimi i faktit që pakësimi i gjendjes cash të deklaruar ka përfshirë edhe vitin 2015, tregon se kjo shumë është përdorur gjatë këtij viti për kryerjen e shpenzimeve të deklaruar. Ndonëse situata faktike nuk është deklaruar saktë në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit duhet lexuar e kuptuar në linjën logjike që ai deklaroi, për sa kohë që ka përshtetur ekzistencën e kësaj shume dhe destinacionin e përdorimit të saj. Duke ndjekur këtë linjë logjike të arsytimit, trupi gjykues vëren se pas korrektimit të analizës financiare të kryer nga Komisioneri Publik për vitin 2015, në zërin e kursimeve vjetore në cash, sipas konkluzionit të arritur më sipër, në zërin e të ardhurave sipas të dhënave të përcjella në Komision nga bankat e nivelit të dytë, në zërin e shpenzimeve të udhëtimit sipas jurisprudencës së Kolegjtit, bazuar në të dhënat e administruara nga sistemi TIMS dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision,

rezultoi se ai gjendet, sërish, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1.100.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve, për vitin 2015, në shumën 348.482 lekë.

51. Për sa u përket kursimeve vjetore në *cash*, të deklaruara në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016, në shumën 1.000.000 lekë, në kushtet kur subjekti në të njëjtën deklaratë ka shpjeguar se nga kjo shumë, *700.000 lekë janë depozituar në Bankën Amerikane të Investimeve më 31.12.2016*, trupi gjykues, duke ndjekur të njëjtin arsyetim si më sipër⁴⁴, vlerësoi se është i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit i parashtruar gjatë gjykimit në Kolegj, se kursimet vjetore në *cash*, më datë 31.12.2016m kanë qenë në shumën 300.000 lekë. Trupi gjykues vëren se këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit e ka gjetur të drejtë edhe Komisioneri Publik, i cili në konkluzionet përfundimtare, në analizën financiare të vitit 2016, ka korrigtuar zërin e likuiditeteve në *cash* në fund të vitit, në shumën 300.000 lekë. Pas korrigtimit të analizës financiare të kryer nga Komisioneri Publik për vitin 2016, në zërin e kursimeve vjetore në *cash*, sipas konkluzionit të arritur më sipër, në zërin e të ardhurave sipas të dhënave të përcjella në Komision nga bankat e nivelit të dytë, në zërin e shpenzimeve të udhëtimit sipas jurisprudencës së Kolegjit, bazuar në të dhënat e administruara nga sistemi TIMS dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, rezultoi se ai gjendet, sërish, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1.000.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2016, në shumën 663.725 lekë.

52. Nga rezultati i analizës financiare të viteve 2003-2016, si dhe bazuar në vlerat e likuiditeteve në formën e depozitave bankare të krijuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë viteve, me burim krijimi kursimet në *cash*, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte kursime të akumuluar në *cash*, në fund të vitit 2016 dhe, për pasojë, ai nuk ka pasur mundësi që në datë 23.01.2017, të kishte gjendje *cash* 5.000 dollarë ose 642.000 lekë⁴⁵, ashtu si ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit⁴⁶.

Në përfundim të arsyetimit, trupi gjykues vëren se, si rezultat i analizës financiare të kryer në Kolegj, për periudhën 2003-2016, pamjaftueshmëria e subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit tip “Audi A4”, kursimet e krijuara në formën e likuiditeteve në depozita bankare dhe në *cash*, si dhe shpenzimet e deklaruara, rezultojnë në vlerën negative 3.466.288 lekë. Mungesa e burimeve të ligjshme qëndron edhe nëse në analizën financiare për periudhën e shqyrtuar, do të shtoheshin në zërin e të ardhurave shumat e konsideruara të krijuara nga burime jo të ligjshme⁴⁷ dhe shpenzimet e jetesës për vitin 2007 do të konsideroheshin në vlerën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, duke rezultuar në vlerën negative prej 1.780.438 lekësh, një vlerë kjo që nuk mund t’i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016⁴⁸, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit⁴⁹.

Rezultati negativ i analizës financiare të kryer në Kolegj rezulton më i thellë se ai prej 2.793.682 lekësh i analizës financiare për periudhën 2003-2016 të kryer nga Komisioneri Publik dhe të debatuar nga palët gjatë gjykimit në Kolegj, pasi Komisioneri Publik, megjithëse

⁴⁴ Shih paragrafin 49 të këtij vendimi.

⁴⁵ Sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të monedhës USD në monedhën lekë, për muajin janar 2017: 1 USD = 128,40 lekë.

⁴⁶ Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* e krijuar nga kursimet e të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes, ndër vite dhe të konvertuara në USD. Vlera 5.000 USD.”

⁴⁷ 450.000 lekë të përfituara nga shitja e makinës tip “Nissan Patrol” në vitin 2005, 290.000 lekë dhuratë nga gjyshërit në vitin 2013, 590.490 lekë, 82.776 lekë dhe 25.000 lekë dhuratë nga të afërmit vajzës së subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në vitet 2014, 2015 dhe 2016.

⁴⁸ Neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “1. Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit”.

⁴⁹ Referuar vendimit nr. 31, datë 18.11.2020, dhe vendimit nr. 18/2021, datë 12.07.2021, të Kolegjit.

shumat e dhuruara vajzës së subjektit të rivlerësimit i ka bërë objekt ankimi lidhur me ligjshmërinë e krijimit të tyre, i ka konsideruar si të ardhura në analizën financiare të viteve përkatëse. Në të kundërt, rezultati negativ i konkluduar nga analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik, për periudhën 2003-2016, do të ishte në shumën 3.872.638 lekë.

53. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit tip “Audi A4”, kursimet e krijuara në formën e likuiditeteve në depozita bankare dhe në *cash*, si dhe shpenzimet e deklaruara, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, duke mos arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, çka sjell si pasojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
54. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit, për pasurinë apartament me sipërfaqe 85,5 m², në Gjirokastër, ndodhet në kushtet e deklaratimit të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga babai i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
55. Komisioni ka kryer kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, duke arritur në konkluzionin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë bindëse dhe se babai i tij ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie. Komisioni ka arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.
Komisioni vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij dhe në përfundim arsyeton se babai i tij e ka blerë apartamentin në gjendje karabina dhe ka kryer punimet për përfundimin e tij, të cilat, sipas deklaratimeve të subjektit shkojnë në total në vlerën 1.900.000 lekë. Fakti se z. S. B. e ka blerë objektin dhe më tej ka vazhduar me ndërtimin dhe përfundimin e tij dhe se të ardhurat e përdorura e kanë burimin nga një gjendje cash kursimesh të tij nga shitja e aktivitetit blegtoral, si dhe fakti se edhe fqinjë të tjerë e kanë blerë shtëpinë në të njëjtat kushte dhe me çmime të ngjashme, krijojnë bindjen se deklaratimet e subjektit janë të vërteta dhe pasqyrojnë gjendjen reale. Po ashtu, mbështetur në provat e administruara duket qartë se pallati është ndërtuar sipas interesave të secilit banor (referuar dritareve, grilave dhe dyerve të jashtme) dhe se ende ka një apartament në gjendje të papërfunduar, çka shton bindjen se ky pallat është shitur në gjendje karabina. Po ashtu, fakti se vlera prej 1.900.000 lekësh e përdorur dhe e deklaruar nga subjekti për këtë apartament ka qenë e disponueshme nga z. S. B., paraprakisht heq dyshimet se subjekti mund të jetë përpjekur për të ndarë vlerën e shpenzuar për këtë apartament, me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme. Trupi gjykues, në vlerësim dhe analizim mes vlerës së deklaruar prej 1.900.000 lekësh dhe vlerës prej 2.074.000 lekësh (85 m² x 24.400), e cila është vlera sipas kostos së ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2003, krijoi bindjen se vlera e deklaruar nga subjekti, duke marrë në konsideratë edhe provat e paraqitura prej tij, është reale dhe duhet pranuar. [...] Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se babai i subjektit ka realizuar aktivitetin e tij në bujqësi, blegtori e bletari, duke realizuar të ardhura nga ky aktivitet dhe se ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003.
56. Komisioneri Publik kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, me pretendimin se ai nuk mbështetet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, si dhe niset nga një premisë e gabuar për t’i dhënë vlerë provuese nivelit deklarativ të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket:
(i) gjendjes “karabina” të pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m² në momentin e blerjes;

(ii) çmimit të blerjes së pasurisë;

(iii) të ardhurave të realizuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, deklaruar si burim për krijimin e pasurisë.

Këtë shkak të ankimit të tij, Komisioneri Publik e mbështet në pretendimet dhe argumentet e mëposhtme.

56.1 Lidhur me gjendjen *karabina* të pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m² në momentin e blerjes, Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, pretendoi se nga shqyrtimi i akteve në dosjen e rivlerësimit, por edhe i provave të administruara rishtas gjatë gjykimit në Kolegj, rezulton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, pasi ai nuk arriti të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2003 dhe akteve të tjera zyrtare, të cilat në kuptim të ligjit përbëjnë provë të plotë, se babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë pasurinë “Apartament banimi 85,5 m²”, të përfunduar plotësisht që në vitin 2003.

56.2 Lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti, Komisioneri Publik vlerësoi se pasuria ka qenë e përfunduar në vitin 2003 dhe referuar Udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, rezulton se vlera e shitjes në tregun e lirë në qytetin e Gjirokastrës është në vlerën 2.923.074 lekë dhe jo 800.000 lekë, sa është përcaktuar në kontratën e noteriale të shitblerjes së pasurisë.

56.3 Lidhur me mundësinë financiare të prindërve të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme, shpenzimet për blerjen e këtij apartamenti, Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka përlllogaritur vetë shumën e të ardhurave të siguruara nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral i prindërve të tij për periudhën 1993-2003. Këto të ardhura të llogaritura nga vetë subjekti nuk bazohen në dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Bazuar në dokumentacionin ligjor të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nëse merret në konsideratë për analogji vërtetimi mbi pagesat e kontributeve në bujqësi të prindërve të subjektit për periudhën 1993 - 2003, rezulton se totali i të ardhurave nga paga minimale për të cilën janë paguar kontributet për këtë periudhë, është, hipotetikusht, në vlerën 1.414.680 lekë. Këto të ardhura nuk mbulojnë shpenzimet për apartamentin as në vlerën e deklaruar nga subjekti, as në vlerën sipas kostos së ndërtimit, bazuar në udhëzimet e kohës së Entit Kombëtar të Banesave dhe as në vlerën sipas kostos mesatare të shitjes në treg të lirë për qytetin e Gjirokastrës.

Në përfundim, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë, në përdorim të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendoi se referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, provohet deklarimi i pasaktë, i pamjaftueshëm dhe mungesa e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë nga babai i subjektit të rivlerësimit.

57. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit në kundërankimin e tij, si dhe në parashtrimet para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me pasurinë objekt kontrolli, janë të pabazuara. Ai prapësoi se babai i tij e ka blerë pasurinë apartament me sipërfaqe 85,5 m², në Gjirokastrë, në gjendjen *karabina*, në vlerën 800.000 lekë, me burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, paraqiti akte të cilat

u administruan në cilësinë e provës⁵⁰ në seancën gjyqësore të datës 26.04.2022, në mbështetje të të cilave pretendoi se:

57.1 Në kundërshtim me provat bindëse të paraqitura prej tij, që vërtetojnë plotësisht gjendjen faktike si *karabina* dhe jo “të përfunduar” të punimeve të këtij apartamenti, Komisioneri Publik, pa paraqitur qoftë edhe një argument të vetëm kundërshtues të tyre, arriti në konkluzionin e gabuar se ky apartament ka qenë i përfunduar në vitin 2003, në momentin e blerjes nga babai i subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit këmbënguli në faktin se akti i kolaudimit të objektit ndërtimor në të cilin ndodhet apartamenti me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë, ka qenë akt fiktiv, pasi faktikisht në katin e tretë të pallatit ekziston ende një apartament në gjendje *karabina*, fakt ky i provuar edhe në Komision përmes fotove. Edhe në aktin e ekspertimit të datës 20.04.2022, eksperti i ndërtimit ka arritur në konkluzionin se në gjendjen në të cilën ende është, objekti ndërtimor për të cilin është lëshuar tashmë një procesverbal kolaudimi, nuk mund të konsiderohet i përfunduar, në zbatim të lejes përkatëse të ndërtimit. Në të njëjtin përfundim arrihet edhe nga leximi i akt-kontrollit të zhvilluar ndaj subjektit ndërtimor, shoqërisë “{***}” ShPK, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë në datë 22.06.2003, sipas të cilit kjo shoqëri nuk ka raste shitjeje të banesave masive, pasi të dyja objektet e ndërtuara në konstruksion nuk janë përfunduar ende. Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.04.2022, evidentohet qartë fakti se sipërmarrësi merrte përsipër t’u ndërtonte objektin porositësve në fazën e konstruksionit *beton/arme* për 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ekzistenca e provave të tilla shpresore të panjohura dhe të pasiguruar gjatë hetimit administrativ në Komision, provon tej çdo dyshimi faktin se shoqëria ndërtimore ia ka shitur babait të tij apartamentin në gjendjen *karabina*, të papërfunduar.

57.2 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi gjithashtu edhe konstatimin e Komisionerit Publik për përlllogaritjen e çmimit të blerjes së apartamentit sipas kostove mesatare të ndërtimit të

⁵⁰ Në seancën gjyqësore të datës 26.04.2020, u administruan në cilësinë e provës:

- akti ekspertimi “Vlerësim teknik i disa pyetjeve në lidhje me objektin ndërtimor, banesë masive e lokale, ndërtues 7-katëshe, e ndodhur në rrugën “{***}”, lagjja “{***}”, Gjirokastrë”, ekspert ing. P. D., Tiranë më 20.04.2022;

- shkresë nr. {***} prot., datë 04.03.2021, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: “Kthim përgjigje”, e cila përmban dokumentacionin e regjistrimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë;

- shkresë nr. {***} prot., datë 07.03.2022, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: “Kthim përgjigje”, e cila përmban dokumentacionin e regjistrimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë;

- shkresë nr. {***} prot., datë 09.03.2022, e Bashkisë Gjirokastrë, Drejtoria e Urbanistikës, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: “Kthim përgjigje”, e cila përmban dokumentacionin e lejes së ndërtimit për objektin në të cilin ndodhet apartamenti me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë;

- shkresë nr. {***} prot., datë 18.03.2022, e Bashkisë Gjirokastrë, Drejtoria e Urbanistikës, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: “Kthim përgjigje”, e cila shprehet se pranë kësaj zyre nuk gjendet dokumentacion për leje shfrytëzimi para vitit 2005;

- shkresë nr. {***} prot., datë 18.03.2022, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: “Kthim përgjigje” se dokumentacioni “Akt kontrolli i grupit të punës” dhe “Raporti përfundimtar i mbikëqyrësit të punimeve” për objektin në të cilin ndodhet apartamenti me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë, nuk ndodhet i depozituar në praktikën e regjistrimit të këtij objekti;

- shkresë nr. {***} prot., datë 06.04.2022, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur së cilës janë përcjellë kopje të kontratave të shitblerjes për apartamentet në objektin ku ndodhet apartamenti me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë;

- shkresë nr. {***} prot., datë 01.04.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, drejtuar z. E. D., ish-administrator i subjektit “{***}”, me lëndë: “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur së cilës gjendet ndër të tjera edhe akti kontrolli, datë 22.06.2003, i zhvilluar ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.

banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, me pretendimin se fakti që shoqëria ndërtimore ia ka shitur babait të tij apartamentin në gjendjen *karabina*, të papërfunduar, përkon edhe me çmimin real të shitjes së një apartamenti të tillë, në vlerën 800.000 lekë, vlerë kjo e njëjtë në të gjitha kontratat e tjera të ngjashme të lidhura ndërmjet shoqërisë ndërtimore dhe banorëve të tjerë të pallatit.

57.3 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi edhe konstatimin e Komisionerit Publik mbi pamundësinë financiare të babait të tij për të blerë apartamentin me sipërfaqe 85,5 m² në vitin 2003, në vlerën 2.923.074 lekë, duke pretenduar se dyshimet mbi disponibilitetin e të ardhurave të ligjshme të babait të tij për blerjen e kësaj pasurie duhet të përqendrohen në argumentimin e vlerës 800.000 lekë, vlerë e cila ishte tërësisht e përbalueshme nga të ardhurat e siguruara nga prindërit e tij nga ekonomia bujqësore dhe blegtorale e tyre në fshatin {***}, Gjirokastër. Subjekti i rivlerësimit argumentoi se rezulton e faktuar me dokumentacion shtetëror se familja e tij ka mbarështuar bagëti të imta dhe të trasha në një numër relativisht të madh dhe, për pasojë, përfitimi nga kjo ekonomi blegtorale nuk mund të vihet në dyshim. Në kundërankim, subjekti i rivlerësimit kishte pretenduar, ashtu sikurse edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, se të ardhurat totale të siguruara nga prindërit e tij për periudhën 1991-2002, nga aktiviteti bujqësor e blegtoral, ishin në shumën 4.496.120 lekë. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti parashtrroi një pretendim tjetër, sipas të cilit për periudhën 01.01.1994 - 31.12.2003, prindërit e tij kanë paguar sigurimet shoqërore si fermerë, fakt që tregon se familja Banushi ka punuar e jetuar në fshat. Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, të ardhurat deri në 4.000 lekë në muaj nuk deklaroheshin dhe nuk tatoheshin. Bazuar në sa më sipër, niveli minimal i të ardhurave të përfituara nga aktiviteti bujqësor e blegtoral për secilin nga prindërit e tij, është deri në 4.000 lekë në muaj, në vlerë totale për të gjithë periudhën në shumën 880.000 lekë, të cilat janë të ardhura neto, për sa kohë që kostot e jetesës janë të parat që plotësohen dhe më pas fermeri del e shet në treg produktet për të tretët. Edhe sipas aktit të ekspertimit, datë 19.04.2022, të kryer nga ekspertja kontabël M. N., arrihet në të njëjtin përfundim, se babai i subjektit të rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme të disponueshme për të blerë apartamentin me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastër, në vitin 2003.

58. Në vijim të sa më sipër, në shqyrtimin e pretendimeve të Komisionerit Publik dhe atyre të subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen e pasurisë objekt kontrolli në momentin e blerjes së saj nga babai i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

58.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi në posedim me nr. {***}, me sipërfaqe 85,5 m², me pronar S. B., babai im, i cili e ka përfutur këtë banesë me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2003, të regjistruar në ZVRPP Gjirokastër në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 10.02.2004”.

58.2 Në deklaratën e interesave të vitit 2003, në rubrikën “Pjesëtarë të familjes me pasuri të regjistruar më vete”, subjekti ka deklaruar: “S. B., i ati, ka blerë me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2003, një apartament banimi të papërfunduar, në shumën 800.000 lekë”. Ndërsa, z. S. B., në formularin A-1, pjesë e deklaratës së pasurisë, ka deklaruar: “Apartament banimi “karabina”; Vlera 800.000 lekë; Lagjja “{***}”, Gjirokastër; Burimi: nga të ardhurat e mia, nga kursimet e mia dhe të gruas sime”.

58.3 Në deklaratimet periodike vjetore nga viti 2003 dhe në vazhdim deri në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi: “Lagjja “{***}”, Gjirokastër.

58.4 Z. S. B., babai i subjektit të rivlerësimit, është pronar i apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 85,5 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastër, sipas regjistrimit hipotekor nr. {***}, datë 10.02.2004. Pronësia mbi këtë pasuri rrjedh nga kontrata e shitjes nr.

{***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2003, lidhur mes z. S. B. dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 800.000 lekë. Shoqëria “{***}” ShPK ka regjistruar pronësinë mbi apartamentin me sipërfaqe 85,5 m² më datë 30.01.2003. Apartamenti është pjesë e ndërtesës “Banesë masive e lokale”, e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit dhënë me vendim nr. {***}, datë 13.03.2002, të KRRt të Bashkisë Gjirokastër. Sipas procesverbalit të datës 06.01.2003, është bërë kolaudimi i objektit dhe më datë 13.01.2003, Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Gjirokastër ka lëshuar Lejen e shfrytëzimit të objektit⁵¹.

58.5 Në kontratën për dhënie trualli për ndërtim nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2002, e lidhur mes investitorëve J. K., Th. D., F. D., me palën pronare të truallit anëtarë të familjes B., për ndërtimin e objektit “Banesë masive e lokale”, është parashikuar se pala investitore do të dorëzojë te pronarët e truallit 6 apartamente dhe pronarët e truallit në përfundim të objektit beton/arme do të ndërtojnë vetë muret rrethuese të apartamenteve të tyre, si dhe do të paguajnë të gjitha detyrimet përpjesëtimore për punimet e ambienteve të përbashkëta, si: kafazi i shkallëve, hidroizolimi i tarracës, kanalet e ujërave të zeza etj., si dhe shpenzimet që i nënshtrohen bashkëpronësisë së detyrueshme të objektit. Pala investitore merr përsipër investimin dhe ndërtimin e objektit sipas lejes së ndërtimit të miratuar, me cilësi të lartë dhe të njëjtë për të gjithë godinën. Me përfundimin e ndërtimit, do të bëhet kalimi i pronësisë ndërmjet palëve, duke marrë pronarët e truallit apartamentet përkatëse, ndërsa investitorët përqindjen e bashkëpronësisë mbi sipërfaqen e truallit.

58.6 Në praktikën e regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme Gjirokastër të ndërtesës “Banesë masive e lokale”, përcjellë në Komision nga AShK Gjirokastër, gjendet edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.05.2002, e përbërë nga dy fletë, sipas së cilës z. J. K., Th. D. e F. D. deklarojnë se kanë lidhur kontratën për dhënie trualli për ndërtim nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2002, me palën pronare të truallit, për pasurinë truall e regjistruar në ZRPP Gjirokastër, në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 17.01.2002, me sipërfaqe 589 m², me adresë lagjja “{***}”, për ndërtimin e objektit “Banesë masive e lokale”. Mbi bazën e kësaj kontrate, ata janë pajisur me vendimin nr. {***}, datë 13.03.2002, të KRRt të Bashkisë Gjirokastër, e cila miratoi sheshin e ndërtimit, si dhe lejen e ndërtimit. Sipas kushteve të kontratës, me deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2022, u përcaktuan me pronarët e truallit ambientet që ata do të merrnin. Deklaruesit, si palë investitore lidhën me shoqërinë “{***}” ShPK, kontratën e sipërmarrjes nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 25.04.2002. Meqenëse ata si investitorë, ishin në pamundësi për t’iu përmbajtur kushteve të kontratës dhe deklaratës noteriale të lidhur me pronarët e truallit, ranë dakord që t’i kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tyre shoqërisë “{***}” ShPK, duke mos pasur asnjë pretendim nga të drejtat e tyre, me kushtin që shoqëria “{***}” ShPK t’u përmbahet të gjitha detyrimeve që u përkasin atyre. Në të njëjtën deklaratë noteriale, deklaruesi E. D., si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroi se është dakord që të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që u përkasin investitorëve të sipërcituar sipas kushteve të parashikuara në aktet e mësipërme. Me nënshkrimin e kësaj deklarate, i lind e drejta ZRPP Gjirokastër, të kryejë veprimet e regjistrimit të objektit “Banesë masive e lokale”, lagjja “{***}”, në bazë të vendimit të miratimit të sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit dhe dokumentacionit të nevojshëm ligjor, në emër të shoqërisë “{***}” ShPK.

E njëjta deklaratë noteriale gjendet edhe në praktikën e regjistrimit të pasurisë, përcjellë subjektit të rivlerësimit nga AShK-ja Gjirokastër, paraqitur prej tij në Kolegj dhe administruar në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 26.04.2022, por e përbërë vetëm nga një

⁵¹ Të dhënat e cituara më sipër burojnë nga informacioni i përcjellë në Komision nga AShK Gjirokastër, me shkresë nr. {***} prot., datë 06.11.2019 dhe nga dokumentacioni që i njëjti institucion i ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2021, i administruar në Kolegj në seancën gjyqësore të datës 26.04.2022.

fletë. Në këto kushte, trupi gjykues i vuri në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.05.2002, e deklaruësve J. K., Th. D., F. D., E. D., redaktuar nga notere A. P., në formën e saj të plotë, megjithëse ky akt gjendej në dosjen e rivlerësimit të krijuar në Komision gjatë hetimit administrativ, e cila i është vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe ai është njohur e ka marrë të gjithë dokumentacionin në CD dhe në formë shkresore fotokopje, siç ka deklaruar me këtë rast në deklaratën e datës 27.12.2019.

58.7 Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.01.2020, të z. E. D., i cili deklaroi se ka qenë administrator i shoqërisë “{***}” ShPK dhe në këtë cilësi, ka lidhur kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2003, për apartamentin me sipërfaqe 85,5 m², në lagjen “{***}” Gjirokastër, me palë blerëse z. S. B. Sipas deklaramit të z. D., z. B., si dhe të gjithë blerësit e tjerë, i kanë blerë pasuritë e tyre që në fazën e karabinasë, vetëm në mure rrethuese të bëra nga shitësi, kurse të gjitha punimet e tjera duke filluar nga muret ndarëse, suvatimet, shtrimi i plakave, dyert e brendshme, dritaret, dyer e jashtme u bënë nga vetë klientët/blerës me shpenzimet e tyre.

58.8 Subjekti ka paraqitur gjithashtu edhe foto të një pallati, i cili sipas tij është godina ku gjendet apartamenti me sipërfaqe 85,5 m² dhe foto të një apartamenti në punim e sipër, i cili sipas subjektit është njëri nga apartamentet, i mbetur akoma në fazën karabina, ashtu siç ka qenë në momentin e shitjes nga shoqëria “{***}” ShPK.

58.9 Në datën 22.06.2003, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër është ushtruar kontroll në shoqërinë “{***}” ShPK lidhur me të ardhurat e realizuara për periudhën tatimore janar - dhjetor 2002. Sipas akt-kontrollit⁵² të hartuar nga grupi i kontrollit tatimor, rezulton se aktiviteti kryesor i shoqërisë “{***}” ShPK, gjatë vitit 2002, ka qenë ndërtimi i dy pallateve private [në njërin prej të cilëve gjendet apartamenti i blerë nga z. S. B.], nga të cilët shoqëria *nuk ka raste shitjesh banesash masive, pasi të dyja objektet e ndërtuara në konstruksion nuk janë përfunduar, për të krahasuar çmimin e shitjes në fakt me atë të Entit Kombëtar të Banesave.*

58.10 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, paraqiti disa kontrata të blerjes së apartamenteve nga banorë të tjerë në ndërtesën në të cilën ndodhet apartamenti i blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit, kontrata të lidhura me shoqërinë “{***}” ShPK, ndër të cilat edhe kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.10.2003, e lidhur mes znj. Q. B., njëra nga pronaret e truallit, e cila i shet z. M. e znj. L. T. apartamentin me sipërfaqe 85,5 m², i regjistruar në pronësi të palës shitëse në datë 28.10.2003.

59. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se apartamentin me sipërfaqe 85,5 m², babai i tij e ka blerë gjendje “karabina”, nuk provohet nga dokumentacioni i paraqitur prej vetë atij dhe i administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, si edhe gjatë gjykimit në Kolegj. Nga

⁵² Akt-kontrolli, datë 22.06.2003, është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike të datës 26.04.2022, si dokumentacion bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 01.04.2022, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër, me lëndë “Kthim përgjigje”, drejtuar z. E. D., ish-administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, e cila është administruar nga trupi gjykues në seancën gjyqësore të së njëjtës datë.

përmbajtja e procesverbalit të kolaudimit, datë 06.01.2003, rezulton se objekti ka qenë i përfunduar dhe jo në fazën “karabina”. Madje në këtë procesverbal, grupi i kolaudimit ka konstatuar edhe disa të meta lidhur me punimet e hidroizolimit, instalimet hidrosanitare dhe instalimet elektrike, për riparimin e të cilave shoqërisë “{***}” ShPK i është lënë afat nga 6-12 muaj. Edhe sipas lejes së shfrytëzimit, datë 13.01.2003, lëshuar nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Gjirokastër, për objektin “Banesë masive e lokale” në lagjen “{***}”, rezulton se objekti ka qenë i përfunduar dhe shfrytëzimi i tij do të fillonte nga data 14.01.2003. Bazuar në nenet 12 e 13 të ligjit të kohës nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, procesverbali i kolaudimit dhe leja e shfrytëzimit të objektit janë akte që hartohen nga personat përgjegjës, pasi janë përfunduar punimet e ndërtimit.

Procesverbali i kolaudimit dhe leja e shfrytëzimit të objektit, pjesë e të cilit është apartamenti me sipërfaqe 85,5 m², janë akte të administruara si pjesë e dokumentacionit që ka shërbyer për regjistrimin në ZVRPP të objektit “Banesë masive e lokale”.

60. Në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme, apartamentit me sipërfaqe 85,5 m², lidhur më datë 25.09.2003, palët nuk shprehen në asnjë moment se ky apartament është dorëzuar në gjendje “karabina”, por përkundrazi, z. S. B., babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse ka deklaruar se pronën e ka marrë në dorëzim nga shoqëria “{***}” ShPK dhe nuk rezulton të ketë shfaqur asnjë pretendim ndaj palës shitëse, në drejtim të gjendjes në të cilën i është dorëzuar apartamenti. Këtë pasuri, shoqëria “{***}” ShPK e ka regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme më datë 30.01.2003, ndërsa z. S. B. ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e saj më datë 23.10.2003, vetëm një muaj nga data e blerjes, dhe regjistrimi është kryer më datë 27.11.2003. Në rast se objekti do të ishte në gjendje “karabina”, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, shoqëria ndërtuese nuk do ta kishte regjistruar dot këtë pasuri dhe as babai i tij, pasi ligji i kohës nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nuk lejonte regjistrimin e ndërtimeve të reja në gjendje “karabina”. [Një regjistrim i tillë është bërë i mundur vetëm pas ndryshimeve të miratuara në ligjin në fjalë, në vitin 2007.] Trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron as pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit, se në kontratën dhënie trualli për ndërtim nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2002, fakti i parashikimit se sipërmarrësi merrte përsipër t’u ndërtonte objektin porositësve në fazën e konstruksionit “beton/arme” për 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, provon se objekti ka qenë i ndërtuar në gjendje “karabina”. Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve të rezultuara nga kontrata e sipërcituar, si dhe nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.05.2002, e lidhur mes investitorëve dhe z. D., administratori i shoqërisë ndërtuese për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me investimin për ndërtimin e objektit te shoqëria “{***}” ShPK, arriti në konkluzionin se investitorët do të përfundonin në fazën beton/arme vetëm apartamentet që u përkisnin pronarëve të truallit në këmbim të sipërfaqes së truallit; përfundimin e punimeve në apartamentet që u përkisnin, ata do t’i përballonin me shpenzimet e tyre.
61. Edhe në kontratat e ngjashme, të lidhura nga shoqëria “{***}” ShPK për shitjen e apartamenteve të tjera në të njëjtin objekt, të paraqitura si provë nga subjekti i rivlerësimit, nuk citohet se apartamentet përkatëse janë shitur në gjendje “karabina”, madje as në kontratën e

shitjes së lidhur mes znj. Q. B. dhe z. M. e znj. L. T. për shitjen e një apartamenti në të njëjtin pallat, për të cilin subjekti pretendon se është ende në gjendje karabina.

62. Trupi gjykues vlerësoi se nuk mund t'u japë vlerë provuese në këtë arsyetim pamjeve fotografike të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendimit të tij se nga këqyrja e fasadës së pallatit, ku rezulton se ngjyrat e duraluminit të dritareve e të dyerve, janë të ndryshme, çka tregon se ato nuk janë vendosur nga firma ndërtuese në kohën e ndërtimit të pallatit, para bërjes së akt-kolaudit, por janë vendosur më vonë, nga vetë blerësit e këtyre apartamenteve, pasi apartamentet e objektit "Banesë masive e lokale", janë shitur në vitin 2003 dhe që nga ajo kohë e deri në vitin 2020, pronarët e apartamenteve mund të kenë bërë ndryshime të nevojshme të dritareve e dyerve, të kushtëzuara për shkak të kohës së gjatë të përdorimit. Edhe fotot e pretenduara se janë të një apartamenti që edhe në ditët e sotme ndodhet në gjendjen "karabina", si në momentin e blerjes, nuk arrijnë të provojnë se kjo gjendje e apartamentit është e tillë që nga momenti i blerjes dhe jo nga ndërhyrje të mundshme të pronarëve të tyre.
63. Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nga kontrolli i zhvilluar ndaj subjektit ndërtimor, shoqërisë "{***}" ShPK, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë në datë 22.06.2003, ka rezultuar se kjo shoqëri nuk ka raste shitjesh të banesave masive, pasi të dyja objektet e ndërtuara në konstruksion nuk janë përfunduar ende, fakt që provon se shoqëria i ka shitur apartamentet në gjendje "karabina", trupi gjykues e gjeti të pabazuar në prova. Në këtë përfundim, trupi gjykues arriti pasi vlerësoi në harmoni të dhënat e rezultuara nga akti i kontrollit në fjalë me të dhënat e aktit të kolaudit dhe lejes së shfrytëzimit të objektit "Banesë masive dhe lokale", sipas të cilave rezulton se shoqëria "{***}" ShPK nuk kishte si të realizonte shitje të apartamenteve gjatë vitit 2002, pasi kolaudimi i objektit të ndërtuar është kryer në datë 06.01.2003 dhe leja e shfrytëzimit të tij është dhënë në datë 13.01.2003.
64. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se apartamenti me sipërfaqe 85,5 m² ka qenë në gjendje karabina në momentin e blerjes nga babai i tij, mbeti i paprovuar. Në kushtet kur blerja e pasurisë apartament në gjendje "karabina" është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, nga babai i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personit të lidhur me të dhe jo nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i arritur se pasuria apartament banimi me sipërfaqe 85,5 m², në Gjirokastrë, ishte në gjendje të përfunduar në momentin e shitjes së saj nga shoqëria ndërtuese të z. S. B., nuk prodhon pasoja konkrete në analizën e vlerësimit të pasurisë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë çmimi i shitjes së saj, i cili do të ishte një element relevant në kuadër të kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve kontraktore të dakordësuara mes palëve, duket se nuk është varur nga gjendja e pasurisë "karabina" apo "e përfunduar", pasi nuk gjendet e referuar në kontratën e shitjes.
65. Në shqyrtimin e pretendimeve të Komisionerit Publik dhe atyre të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e blerjes së pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë, trupi gjykues konstatoi se babai i subjektit të rivlerësimit, z. S. B., ka blerë pasurinë objekt kontrolli, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2003, lidhur me tij dhe shoqërisë "{***}" ShPK, sipas së cilës çmimi i shitjes është 800.000 lekë. Gjatë hetimit

administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontrata të tjera të ngjashme⁵³, të lidhura ndërmjet shoqërisë ndërtimore “{***}” ShPK dhe blerësve të tjerë të apartamenteve në ndërtesën ku ndodhet apartamenti objekt kontrolli. Nga verifikimi i këtyre kontratave, rezulton se kanë përmbajtje të ngjashme me kontratën e lidhur mes z. S. B. dhe shoqërisë së ndërtimit dhe çmimi i dakordësuar nga palët është i njëjtë, në vlerën 800.000 lekë.

66. Në analizë të fakteve të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vëren se palët në gjykim, mbrojtjen e pretendimeve lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë objekt kontrolli, e kanë lidhur ngushtësisht me gjendjen e ndërtimit të pasurisë në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes. Komisioneri Publik, në vijim të pretendimit se pasuria është blerë si ndërtim i përfunduar, ka pretenduar se vlera e shitblerjes së pasurisë, apartament me sipërfaqe 85,5 m², siç ajo është përcaktuar në kontratën e shitjes, është dukshëm më e ulët se vlera e shitjes në tregun e lirë në këtë qytet, ndërsa subjekti i rivlerësimit pretendoi se çmimi i blerjes së saj përputhet plotësisht me blerjen në gjendje “karabina”. Trupi gjykues, megjithëse më sipër në këtë vendim arriti në konkluzionin se pasuria apartament ka qenë ndërtim i përfunduar në momentin e shitjes, në interpretim të nenit 690 të Kodit Civil, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson se kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2003, lidhur mes z. S. B. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, ka vlerë të plotë provuese lidhur me çmimin e deklaruar në të, të dakordësuar nga palët, në vlerën 800.000 lekë. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues u mbështet edhe në faktin se Komisioneri Publik, në ankim, nuk ka ngritur dyshime dhe, për pasojë, nuk ka parashtruar nevojën e hetimit nëse shoqëria “{***}” ShPK kishte arsye për t’ia shitur pasurinë apartament babait të subjektit të rivlerësimit, me një çmim më të lirë se vlera e tregut, arsye që mund të lidhen me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit, në çështje gjyqësore, në të cilat

⁵³ - Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2003, lidhur mes z. A. M. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 92 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë.

- Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2003, lidhur mes z. M. Dh. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 92 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 800.000 lekë.

- Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.10.2003, lidhur mes znj. Q. B. dhe z. M. e znj. L. T., për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 85,5 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 800.000 lekë.

- Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.2003, lidhur mes z. I. Xh. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 87 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 900.000 lekë.

- Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2003, lidhur mes z. A. S. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 85,5 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 800.000 lekë.

- Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2003, lidhur mes z. S. Dh. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 85,5 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 800.000 lekë.

- Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.01.2004, lidhur mes z. S. Dh. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 92 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 800.000 lekë.

- Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.08.2003, lidhur mes z. F. D. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitjen e apartamentit me nr. {***}, zona kadastrale {***}, me sipërfaqe 85,5 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 800.000 lekë.

kjo shoqëri mund të ketë qenë palë⁵⁴; si dhe në faktin se kontratat e ngjashme të shitjes, për apartamente që ndodhen në të njëjtën ndërtesë me apartamentin me sipërfaqe 85,5 m², referojnë të njëjtin çmim shitjeje me të, duke krijuar bindjen se ky është çmimi që shoqëria ka përlllogaritur për shitjen e apartamenteve, pjesë e objektit “Banesë masive e lokale”.

67. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, se ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, ai konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit, nuk mund të konsiderohet si dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, duke mos provuar mundësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, blerjen e këtij apartamenti në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit, në kundërankim, ka parashtruar se Komisioneri Publik ka arritur në konkluzionin e gabuar për pamundësinë financiare të prindërve të tij për të mbuluar me të ardhura të ligjshme vlerën e blerjes së këtij apartamenti, sipas kontratës së shitblerjes së vitit 2003, pasi, ashtu siç ka argumentuar edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer në Komision, të ardhurat totale të prindërve të tij nga blegtoria, vreshtaria dhe bletaria për periudhën 1991-2002, kanë qenë 4.496.120 lekë. Kjo gjendje e të ardhurave të realizuara nga prindërit e tij për këtë periudhë kohore, është tregues i mundësisë së tyre financiare, jo vetëm për realizimin e blerjes së apartamentit të banimit në vlerën reale të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, por edhe në vlerën së cilës i referohet Komisioneri Publik. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur argumente të reja nga ato në kundërankim, duke pretenduar se prindërit e tij kanë qenë anëtarë të kooperativës dhe për këtë shkak, kanë përfituar nga shpërndarja e pasurisë së kooperativës tek ish-anëtarët e saj, bazuar në ligjin nr. 7745, datë 26.07.1993, “Për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 16.09.1993. Për sa më sipër, nuk mund të vihet në dyshim që familja e tij ka përfituar nga pasuria e kooperativës, jo vetëm tokë, por edhe bagëti të imta dhe të trasha, fakt ky i provuar dhe nga aktet e paraqitura prej tij e të administruara në cilësinë e provës në Kolegj. Subjekti i rivlerësimit ka vijuar pretendimet e tij, duke argumentuar se prindërit e tij për periudhën 1994-2003, kanë paguar sigurimet shoqërore si fermer dhe, bazuar në ligjin e kohës nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, të ardhurat deri në nivelin 4.000 lekë/muaj nuk tatohen. Edhe bazuar në një nivel minimal të ardhurash si familje, prej 8.000 lekësh në muaj, të ardhurat e vlerësuara janë në shumën 880.000 lekë. Duke mbajtur në konsideratë që të ardhurat e fermerëve janë të ardhura *neto*, subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e prindërve të tij në shumën e sipërcituar, duke u kualifikuar si të ardhura të ligjshme, mbulojnë blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m², në vitin 2003.
68. Në verifikimin e mundësisë së z. S. B. për të blerë apartamentin me sipërfaqe 85,5 m² me burime të ligjshme, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se prindërit e tij kanë krijuar të ardhura prej aktivitetit në bujqësi, vreshtari, blegtori e bletari, në shumën 4.496.120 lekë, mbetet vetëm në kuadër të një deklarami, i pambështetur në asnjë burim prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016, referuar burimeve të provave që mund të

⁵⁴ Duke mbajtur në vëmendje se ligji nr .9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” është miratuar në datën 7.4.2005, më vonë në kohë sesa momenti i lindjes së marrëdhënies juridike objekt shqyrtimi.

provojnë krijimin apo gjenerimin e të ardhurave, në kuptim të këtij procesi. Provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj⁵⁵, arrijnë të provojnë se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë ushtruar aktivitet në bujqësi e blegtori si të vetëpunësuar në këtë sektor, por jo shumë të ardhurave të gjeneruara nga ky aktivitet.

Për sa i përket pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se prindërit e tij kanë krijuar të ardhura të ligjshme nga aktiviteti bujqësor e blegtoral për periudhën 1994-2003, në shumën 880.000 lekë, trupi gjykues, bazuar në aktet e paraqitura nga subjekti e të administruara në

⁵⁵ Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet:

- deklarata me shkrim dore të z. J. K., z. K. K., z. K. M. dhe z. V. N., të cilët kanë deklaruar se kanë blerë bagëti nga z. S. B. në vitin 2003;
- vërtetim nr. {***} prot., datë 08.04.2019, i Bashkisë {***}, Sektori i shërbimit bujqësor, blegtoral e mjedisor, me të cilin vërtetohet se z. S. B. ka kryer aktivitet blegtoral deri në vitin 2003;
- vërtetim i mjekut veteriner B. B., i vulosur prej këtij të fundit, datë 08.04.2019, sipas të cilit z. S. B. ka pasur në pronësi bagëti nga viti 1992 deri në vitin 2002;
- vërtetim nr. {***} prot., datë 31.12.2019, i Bashkisë {***}, sipas të cilit z. S. B. ka kryer aktivitet blegtoral deri në vitin 2003 dhe që para viteve '90 e në vazhdim merret me vreshtari dhe me mbarëshkrimin e bletëve;
- vërtetim, datë 05.01.2020, i kryeplakut të fshatit {***}, z. Z. G., sipas të cilit z. S. B. nga viti 1993 deri në vitin 2003, ka kryer aktivitet bujqësor dhe blegtoral, pas vitit 2003 është marrë me bujqësi, vreshtari e bletari;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.11.09.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 968 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.11.09.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 2125 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimi;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.11.09.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 2410 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.11.09.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 1189 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.11.09.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 2060 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.20.01.2010, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 500 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.20.01.2010, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 420 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.20.01.2010, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 7800 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.20.01.2010, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, arë, sip. 2400 m², bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.20.01.2010, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, truall , sip. 300 m² (banesa aktuale), bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.12.05.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, truall , sip. 250 m², kthyer me vendimin nr. 138, dt. 25.08.1994, të K.K.K.Pronave ish-Pronarëve, Gjirokastër, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt. 12.05.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, truall, sip. 1000 m², kthyer me vendimin nr.138/1, dt.25.08.1994 të K.K.K.Pronave ish-Pronarëve, Gjirokastër, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.12.05.2009, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, truall , sip. 570 m², kthyer me vendimin nr. 526, dt.16.04.1998, të K.K.K.Pronave ish-Pronarëve, Gjirokastër, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.04.06.2015, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, pemëtore, sip. 450 m², në posedim të pandërprerë dhe kthyer me vendim të K.K.K.Pronave ish-Pronarëve, Gjirokastër, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie, dt.04.06.2015, z. S. B., pasuria nr. {***}, ZK{***}, truall , sip. 227 m², në posedim të pandërprerë dhe kthyer me vendim të K.K.K. Pronave ish-Pronarëve, Gjirokastër, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.

Gjatë gjykimit në Kolegj u administruan në cilësinë e provës, në seancën gjyqësore të datës 26.04.2016, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

- vërtetim nr. {***} prot., datë 15.04.2022, i Bashkisë {***}, Protokoll Arkiva, sipas të cilit z. S. B. ka qenë kryetar i kryesisë së fshatit {***} dhe ka përfutuar të ardhura nga ky pozicion;
- shkresë nr. {***} prot., datë 01.04.2022, e Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendore, drejtuar z. Dritan Banushi, me lëndë: "Kthim përgjigje për të dhëna arkivore", sipas së cilës në arkiva nuk gjendet dokumentacion në lidhje me kooperativën bujqësore {***}, Gjirokastër;
- shkresë nr. {***} prot., datë 08.04.2022, e Drejtorisë Rajonale Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve, Vlorë;
- vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 11.04.2022, i noteres G. R. K., librezë pune S. B.

cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegji⁵⁶, si dhe në bazë të parashikimeve të legjislacionit tatimor të kohës⁵⁷, vlerësoi se ky pretendim është i drejtë. Në kryerjen e analizës financiare për periudhën 1994-2003, trupi gjykues arriti në përfundimin se shpenzimet e kryera nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, në shumën 2.388.483 lekë, në të cilat krahas shpenzimeve për blerjen e apartamentit janë shtuar dhe shpenzimet e jetesës sipas jurisprudencës së Kolegjit, tejkalojnë të ardhurat e ligjshme të cilat janë në shumën 920.014 lekë [duke përfshirë këtu edhe të ardhurat e përfituara nga z. S. B. si kryetar i Kryesisë së fshatit {***}], duke rezultuar një diferencë negative prej 1.031.280 lekësh. Si rrjedhojë e rezultatit të analizës financiare, trupi gjykues arriti në konkluzionin se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kishin mundësi që, me burime të ligjshme, të blinin pasurinë apartament me sipërfaqe 85,5 m² në Gjirokastrë.

69. Pavarësisht arsytimit të mësipërm, i cili ishte i kushtëzuar nga nevoja për t'u dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues konstatoi se Komisioneri Publik në ankim, por edhe Komisioni në vendim, kontrollin dhe verifikimin lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 85,5 m², e kanë justifikuar vetëm me faktin e deklaramit nga subjekti i rivlerësimit se ndodhet në kushtet e përdorimit të këtij apartamenti, duke mos i dhënë asnjë cilësim marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit e prindërve tij, në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm. Trupi gjykues vëren se, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, konkretisht pikat 9 dhe 14 të nenit 3 të tij, si dhe pika 4 e nenit 32, kontrolli dhe verifikimi i pasurive të personave të tjerë, të ndryshëm nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, justifikohet vetëm nëse mes subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë ekzistojnë/konfirmohen marrëdhënie të dhurimit, huadhënies ose huamarrjes, si pasojë e të cilave ata kualifikohen si “persona të tjerë të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, e për këtë shkak, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive⁵⁸. Në analizë të marrëdhënies së përdorimit të apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni dhe Komisioneri Publik kanë konstatuar saktë ekzistencën e një marrëdhënieje përdorimi të këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2005 e në vazhdim, por nuk i kanë dhënë një kualifikim kësaj marrëdhënieje, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që do të çonte subjektin e rivlerësimit në detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas këtij parashikimi ligjor. Vlerësimin lidhur me përdorimin e pasurive të prindërve nga subjektet e rivlerësimit, Kolegji e ka trajtuar në jurisprudencën e tij të konsoliduar tashmë⁵⁹, sipas së cilës përdorimi i pasurisë

⁵⁶ Shkresë nr. {***} prot., datë 28.03.2022, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, drejtuar znj. A. B., me lëndë: “Kthim përgjigje”.

Shkresë nr. {***} prot., datë 28.03.2022 e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, drejtuar z. S. B., me lëndë: “Kthim përgjigje”.

Vërtetim nr. {***} prot., datë 15.04.2022, e Bashkisë {***}, Protokoll Arkiva, sipas të cilit z. S. B. ka qenë kryetar i kryesisë së fshatit {***} dhe ka përfutuar të ardhura nga ky pozicion.

⁵⁷ Sipas nenit 4 të ligjit të kohës nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”: “Të ardhurat deri në 4.000 lekë në muaj përjashtohen nga tatimi”.

⁵⁸ Sipas përkufizimit të dhënë në pikat 9 dhe 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që një person fizik ose juridik të konsiderohet si “person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit”, duhet që të provohet një lidhje interesi mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga: i) një interes pasuror; ose ii) çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Ndërsa lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është trajtuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror.

⁵⁹ Vendimet e Kolegjit nr. 7/2020 (JR), datë 24.06.2020; nr. 8/2020 (JR), datë 25.06.2020; nr. 21/2020 (JR), datë 10.09.2020; nr. 4/2021 (JR), datë 09.02.2021 dhe nr. 24/2021 (JR), datë 28.07.2021 dhe nr. 10/2022 (JR), datë 14.04.2022.

apartament, si një marrëdhënie huapërdorjeje del jashtë kategorisë së marrëdhënieve të cilat do ta vendosnin babain e subjektit në statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ky fakt nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në kushtet kur nuk provohet se ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se mbahet në emër të personave të tjerë të lidhur apo individëve të tjerë, që nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e këtij ligji.

70. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në përputhje me detyrimin kushtetues të parashikuar në nenin D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, edhe atë ligjor të parashikuar në shtojcën nr. 1 të ligjit nr. 84/2016. Deklarimi i kësaj pasurie është bërë edhe nga z. S. B. në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, në të cilën ka deklaruar apartamentin në pronësi të tij, si dhe burimet e krijimit⁶⁰. Të njëjtin qëndrim subjekti ka mbajtur edhe në përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, duke shpjeguar se ka filluar të banojë në apartamentin në pronësi të babait të tij, në vitin 2005⁶¹. Në deklaratën periodike të vitit 2005 e në deklaratat në vijim, subjekti ka deklaruar si adresë banimi, atë të vendndodhjes së apartamentit në pronësi të babait të tij. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në mënyrë konsistente ka deklaruar pasurinë e paluajtshme në përdorim, nuk arrihet të provohet ndonjë përpjekje e tij për të fshehur këtë pasuri, me qëllim shmangien e kontrollit për shkak të procesit të rivlerësimit, megjithëse nuk rezulton që Komisioneri Publik të ketë ngritur ndaj subjektit ndonjë dyshim për ndonjë rrethanë që mund të çonte te hipoteza e një pasurie të fshehur të tij. Gjithashtu, dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston, për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare mes subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij, por edhe për faktin se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m², nuk kishte legjislacion në fuqi mbi konfliktin e interesit, pasi kuadri ligjor përkatës ka hyrë në fuqi në vitin 2005.
71. Në mbështetje të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se përdorimi i pasurisë së prindërve nga subjekti i rivlerësimit nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozitat e sipërcituara, në kuptim të të cilave të mund të kualifikojë z. S. B. si person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe të ngarkojë prindërit e subjektit dhe vetë atë me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 85,5 m². Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, nuk gjendet në kushtet e ngarkimit me përgjegjësi disiplinore në kuadër të procesit të rivlerësimit, lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 85,5 m², në përdorim të tij.

⁶⁰ Deklarimi i z. S. B. si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të qenies në atë kohë, në të njëjtin trung familjar.

⁶¹ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit administrativ në Komision se në vitet 2003-2004, ka jetuar në apartamentin e prindërve të bashkëshortes së tij [i cili nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, rezultoi të ndodhet në lagjen “{***}”, Gjirokastër], ndërsa nga viti 2005 e në vijim jeton në apartamentin në pronësi të prindërve, të cilët gjatë muajve të dimrit jetojnë aty, ndërsa muajt e tjerë jetojnë në fshat.

72. Trupi gjykues, në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, pasi dëgjoi dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, aktet e depozituara në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj nga palët, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Dritan Banushi gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 229, datë 28.01.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i pambështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 08.06.2022.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me zgjidhjen e çështjes me vendimin nr. 18, datë 08.06.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr. 229, datë 28.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi, por kam mendim ndryshe me shumicën e trupit gjykues sa i përket arsytimit në paragrafët 69 dhe 71 të këtij vendimi, lidhur me moskualifikimin si “person tjetër të lidhur” të babait të subjektit të rivlerësimit, sa i përket marrëdhënies së përdorimit të apartamentit për periudhën 2005 e në vazhdim.
2. Në vlerësimin tim, në vijimësi të qëndrimit konstant të mbajtur prej meje përgjatë shqyrtimit të çështjeve në Kolegj, sa i takon përdorimit të një pasurie të paluajtshme në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit apo kujtudo tjetër, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, përveç detyrimit për të evidentuar saktë marrëdhënien juridike që e lidh me pasurinë në përdorim, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, subjekti i rivlerësimit ngarkohet dhe me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë në përdorim, i cili urdhërohet nga dispozita kushtetuese e cituar më sipër, si dhe parashikimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, i cili përkufizon si *person tjetër të lidhur* edhe atë që ka një interes pasuror me subjektin e rivlerësimit, situatë e cila çon në detyrimin e subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë, pasi ka pasur interes pasuror duke përdorur për një kohë të gjatë apartamentin në pronësi të babait.
3. Në këto kushte, lidhur me apartamentin me sipërfaqe 85,5 m², të ndodhur në Gjirokastrë, në pronësi të z. S. B., babait të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, të cituara në paragrafin më sipër, ndryshe nga arsytimi i shumicës, vlerësoj se babai i subjektit të rivlerësimit klasifikohet në cilësinë e *personit tjetër të lidhur*, dhe subjekti i rivlerësimit ngarkohet me përgjegjësinë ligjore të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi